



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 43/2022 regjistër (JR)  
Datë 27.09.2022

Nr. 49 i vendimit  
Datë 23.06.2025

**V E N D I M**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, më datë 23.06.2025, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit, z. Çlirim Sino, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 547, datë 06.07.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Çlirim Sino.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 42 dhe neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 2, 62, 63 dhe neni 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenet 46 e vijues të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në datën 05.06.2025 dhe në seancë gjyqësore publike, në praninë e subjektit të rivlerësimit, në datën 16.06.2025, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim, në parashtrimet e depozituara në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe në seancën gjyqësore publike, nëpërmjet të cilave ai kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 547, datë 06.07.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores, Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Çlirim Sino (në vijim, “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe 41 pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim, “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, “DSIK”), dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), prej të cilave rezultoi si më poshtë:
  - 2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm, sipas të cilit: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) ka mosdeklarime ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
  - 2.2. DSIK-ja, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës, ka përcjellë raportin e vlerësimit të përditësuar për subjektin e rivlerësimit, duke konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.
  - 2.3. KLP-ja kreu vlerësimin e aftësive profesionale, duke analizuar formularin e vetëdeklarimit dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë këtë formular; tre (3) dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; pesë (5) dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënat nga burimet arkivore pranë KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Në përfundim të procedurës së kontrollit i dërgoi Komisionit një raport të hollësishëm.

3. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të kryer duke u bazuar në të tria kriteret, konkludoi me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra me vendimin objekt shqyrtimi. Arsytimi i Komisionit përmbledhet në vijim.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

4. Vendimi objekt ankimi, nëpërmjet të cilit Komisioni vendosi shkarkimin e subjektit nga detyra, u bazua në vlerësimin përfundimtar se:
  - a. Subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e *kriterit të pasurisë* dhe ndodhet në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
  - b. Në lidhje me *kriterin e kontrollit të figurës*, subjekti i rivlerësimit i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm, pasi ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nga hetimet nuk ka rezultuar që ai të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
  - c. Në vlerësimin e *aftësive profesionale*, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues të kërkuar sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

## **III. Shkaqet e ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit**

5. Në datën 23.05.2022, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim kundër vendimit të Komisionit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin e tij në detyrë. Bashkë me ankimin, subjekti ka depozituar pesë (5) akte,<sup>1</sup> duke kërkuar administrimin e tyre në cilësinë e provës. Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, në datën 21.05.2025, subjekti ka paraqitur në Kolegj parashtrime shtesë të pashoqëruara me akte. Shkaqet e ankimit grupohen në ato me natyrë procedurale, që lidhen me procesin e rregullt ligjor, dhe shkaqe që lidhen me themelin e çështjes, e konkretisht, kundërshtime lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë.

5.1. Subjekti pretendon se ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë. Pasuritë e tij dhe të personave të lidhur janë deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ka provuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive në pronësi, në posedim ose në përdorimin e tij dhe nuk është përpjekur t'i fshehë ato apo t'i paraqesë në mënyrë të pasaktë.

5.2. Me pretendimin se Komisioni ka vepruar në shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim KEDNj), për shkak se ka zhvilluar një proces në shkelje të rënda

---

<sup>1</sup> Konkretisht, me ankimin, subjekti ka përcjellë: Akt-raport i Analizës Financiare nga audituesi ligjor (tabela e analizës financiare 2005 – 2016); të dhëna nga bankat e nivelit të dytë (statement të llogarive bankare të personit fizik A. S., në BKT dhe Union Bank); hapje kontrate, depozitë me afat, datë 14.09.2022 dhe dy vërtetime, datë 13.09.2022, të BKT-së, për A. S., me nr. {\*\*\*} prot. dhe nr. {\*\*\*} prot.

procedurale, që e bëjnë atë të pavlefshëm, dhe në kushtet që ndaj tij është marrë një vendim i paarsyetuar në disa aspekte, subjekti kërkon që gjykimi i çështjes në Kolegj të bëhet *në seancë dëgjimore publike*, me praninë e tij, në garatim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe me qëllim vlerësimin e drejtë të provave të administruara në Komision dhe atyre të depozituara me ankimin, në funksion të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike. Përfundimisht, subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 547, datë 06.07.2022, dhe konfirmimin e tij në detyrë.

### ***III/1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale***

5.3. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti pretendon se i është cenuar rëndë e drejta për një proces të rregullt ligjor, e mbrojtur nga neni 6 i KEDNj-së, për shkak të mosrespektimit nga ana e Komisionit e disa parimeve që e garantojnë atë. Subjekti është vlerësuar nga një trup gjykues që nuk përmbushte kriteret e një gjykate të pavarur dhe të paanshme, për shkak se anëtarët e tij nuk përmbushnin kriteret e zgjedhshmërisë, ata kryen funksione të dubluara të spektrit hetimor dhe gjyqësor, dhe vepruan si një “gjykatë e jashtëzakonshme”, duke zhvilluar një proces të paragjykuar dhe marrë një vendim subjektiv e të paravendosur. Arsytet që e shtynë trupin gjykues të veprojë nën doza të larta paragjykimi, sipas subjektit, mbeten “të paqarta” për të. Për rrjedhojë, procesi i zhvilluar në Komision përfshirë edhe aktet e prodhuara gjatë tij dhe vendimmarrjet e ndërmjetme e përfundimtare, janë të pavlefshme, pasi janë kryer e marrë nga një gjykatë e formuar jo sipas ligjit.

5.4. Subjektit i është cenuar parimi i sigurisë juridike, i sanksionuar në nenin 7 të KEDNj-së. Ai është “dënuar” administrativisht “pa faj”, në lidhje me pamundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes për të krijuar shumat e dhuruara asaj, përpara martesës me subjektin. Thënë ndryshe, kjo pamjaftueshmëri edhe sikur të provohet, nuk është e subjektit e as ka lidhje me pasuritë e tij dhe si e tillë, nuk mund të shërbejë si shkak ligjor për shkarkimin e subjektit nga detyra.

5.5. Subjektit i është mohuar e drejta për t’u mbrojtur për shkak të mosrespektimit të parimit të kontradiktoritetit. Komisioni i ka kaluar barrë prove të paarsyeshme në lidhje me apartamentin e financuar nga prindërit e bashkëshortes përpara lidhjes së martesës dhe nuk i ka kaluar fare barrë prove për disa konstatime për një depozitë në emër të personit fizik të bashkëshortes, me të cilat subjekti është njohur vetëm pas publikimit të vendimit përfundimtar.

### ***III/2. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë***

5.6. Pretendimet për shkelje materiale, që lidhen me themelin e vlerësimit të kriterit të pasurisë, kanë për fokus vlerësimin e Komisionit për pasuritë në raport me provat dhe dispozitat ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti pretendon se nuk ndodhet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Pasuritë e tij dhe të personave të lidhur janë deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka provuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive në pronësi, në posedim ose në përdorimin e tij dhe nuk është përpjekur t’i fshehtë ato apo t’i paraqesë në mënyrë të pasaktë. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe

plotësisht pasuritë e tij. Ai nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklaram të rremë dhe subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. Pasaktësitë në deklarime nuk dëshmojnë përpjekje për të fshehur apo për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo përdorim, për rrjedhojë, këto konstatime nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi bien ndesh me pikat 1, 2, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 59 e 61 të ligjit nr. 84/2016, në një interpretim sistematik e logjik të këtyre dispozitave të para së bashku.

5.7. Vendimi i Komisionit është marrë në shkelje të parimit të sigurisë juridike, pasi janë përdorur koncepte të paqarta e të pasqaruara në ligjin nr. 84/2016, sikurse janë “deklarimi i pamjaftueshëm i të ardhurave” apo “deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë”, si edhe për shkak të mosaplikimit të përcaktimit kushtetues të “dyfishit të pasurisë së ligjshme”.

5.8. Konkluzionet në vendimin përfundimtar janë të gabuara dhe të paragjykuara, sepse nuk janë rrjedhojë e vlerësimit të drejtë dhe të paanshëm të shpjegimeve e provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, provat e paraqitura pas kalimit të barrës së provës, si dhe provat e administruara nga vetë Komisioni gjatë këtij procesi.

5.9. Komisioni, në asnjë fazë të hetimit administrativ, përfshirë dhe seancën dëgjimore, nuk i ka kaluar barrën e provës për rezultatin financiar të vitit 2016, në lidhje me një depozitë prej 43.000 eurosh, në emër të bashkëshortes së tij si person fizik. Ky konkluzion, që është shkaku më i rëndë dhe që përcaktoi vendimmarrjen, iu bë i ditur vetëm pas komunikimit të vendimit përfundimtar. Mosnjoftimi i kësaj gjetjeje përbën shkelje të rëndë të parimit të kontradiktoritetit dhe të drejtës për t’u dëgjuar e mbrojtur efektivisht.

5.10. Pretendimet e mësipërme dhe ato të potencuara në mënyrë konkrete për disa pasuri trajtohen më në detaje në vijim të këtij vendimi.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

##### ***A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj***

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja objekt shqyrtimi bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, duke qenë subjekt rivlerësimi, në kuptim të dispozitave kushtetuese e ligjore që rregullojnë këtë aspekt, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

7. Seanca e datës 05.06.2025 u zhvillua në dhomë këshillimi, në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin gjyqësor në Kolegj, e konkretisht nenet 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016<sup>2</sup> dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012<sup>3</sup>, në kushtet që nuk u konstatua asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga ligji për kalimin në seancë gjyqësore publike në praninë e subjektit, qoftë për aspektet procedurale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit apo kërkesën e tij për të marrë prova të reja, si dhe nuk u evidentua asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar<sup>4</sup>. Arsyetimi mbi të cilin u vendos gjykimi i çështjes në dhomë këshillimi shtjellohet në vijim.

7.1. Subjekti ka përcjellë disa akte me ankimin, të cituara më sipër, në poshtëshënimin nr. 1. Trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se këto akte nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, për rastet përjashtimore, në të cilat provat e reja pranohen bashkë me ankimin, për shkaqe që janë jashtë kontrollit të palëve.<sup>5</sup> Konkretisht, katër prej tyre,<sup>6</sup> pavarësisht datës së përpilimit/printimit, nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas datës 06.07.2022, kur Komisioni ka dhënë vendimin objekt ankimi. Nëpërmjet tyre, subjekti kërkon të konfirmojë të dhëna/ngjarje/veprime të krijuara/ndodhura/kryera përpara dhënies së vendimit, për rrethana për të cilat subjektit i kishte kaluar barrë prove dhe i ishte kërkuar të japë shpjegime. Në kushtet që subjekti nuk ka argumentuar për pamundësi për t'i përcjellë ato më parë, këto akte nuk përmbushin kriteret ligjorë për t'u pranuar me ankimin.

---

<sup>2</sup> “[1.] Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012, ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’. [...]”.

<sup>3</sup> Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili, në nenin 49, parashikon: “[1.] Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. 2. Kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes, të paktën 15 ditë përpara. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. 3. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor”.

<sup>4</sup> Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[1.] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja, kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankim është bazuar në shkelje të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë. [...]”.

<sup>5</sup> Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 parashikon që: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se, pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

<sup>6</sup> Në këtë grupim janë: (i) Akt-raporti i Analizës Financiare nga audituesi ligjor (tabela e analizës financiare 2005 – 2016); (ii) të dhëna nga bankat e nivelit të dytë (statement i llogarive bankare të subjektit fizik “A. S.”, në BKT dhe Union Bank) dhe dy vërtetime me nr. {\*\*\*} prot. dhe nr. {\*\*\*} prot., lëshuar në datën 13.09.2022, nga BKT, për A. S.

7.1.a. Dy prej tyre përbëjnë printime të lëvizjeve të dy llogarive bankare të personit fizik në emër të bashkëshortes së subjektit, për periudhat 01.01.2016 – 13.09.2022 dhe 01.09.2010 – 14.09.2022, të cilat, më së paku deri në korrik 2022, mund të ishin përcjellë në Komision përpara vendimmarrjes. Nën të njëjtën linjë arsyetimi nuk u pranuan në cilësinë e provës edhe dy vërtetimet e lëshuara nga një bankë e nivelit të dytë [BKT], të cilat konfirmojnë balancat në llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit, në datën 31.12.2016.

7.1.b. Sa i përket një shkrese, nëpërmjet së cilës referohet hapja e një kontrate depozitë me afat në datën 14.09.2022, trupi gjykues vëren se ky akt provon një veprim konkret të kryer në këtë datë nga bashkëshortja e subjektit dhe jo fakte të ngjara më herët.

7.2. Nën dritën e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, provë e re do të ishte një akt që provon një të dhënë/veprim/ngjarje të ndodhur më herët, para dhënies së vendimit, por që nuk mund të provohej deri pas vendimit, pa faj të subjektit të rivlerësimit. Ky i fundit ka dështuar të provojë pamundësinë e tij për t'i paraqitur këto akte në Komision, e po ashtu nuk rezultoi që të ketë ngritur pretendime me natyrë shkeljesh procedurale të kryera nga Komisioni, me fokus refuzimin e administrimit të provave të kërkuara prej subjektit. Nga ana tjetër, edhe duke abstraguuar nga arsyetimi i mësipërm, këto prova u vlerësuan të panevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, pasi janë të panevojshme e pa efekt në zgjidhjen e çështjes. Për shkak të përmbajtjes së tyre, që pasqyrojnë ngjarje që paradatojnë vendimin, trupi gjykues vlerëson se përpilimi i këtyre akteve pas vendimit përfaqëson logjikisht një mjet, nëpërmjet të cilit subjekti është përpjekur të mundësojë kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

7.3. Trupi gjykues i Kolegjit nuk gjen asnjë arsye të qenësishme në përpilimin e raportit të analizës financiare të hartuar nga një auditues i pajtuar prej subjektit, pikërisht në fazën e ankimit, ndonëse e kishte dorëzuar një të tillë në seancë dëgjimore<sup>7</sup>. Edhe më herët, në fazën e prapësimeve, subjekti ka pranuar se është asistuar nga një auditues në lidhje me analizat financiare<sup>8</sup>. Pavarësisht faktit që ky akt i ri ekspertimi nuk vlerësohet si shkak që dikton kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në kuptim të neneve 51 dhe 47 të ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues vlerësoi ta pranojë këtë akt në funksion të kontrollit të pasurisë dhe në vijim të arsyetimit të elaboruar në këtë vendim, në shkakun e ankimit të cilit ai i përket.

7.4. Trupi gjykues vlerësoi edhe që nuk ka shkelje procedurale të kryera nga Komisioni gjatë procesit të kryer pranë tij. Në këtë kontekst verifikimesh me fokus procedurën, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit për moskalimin e barrës së provës sa i përket rezultatit financiar të vitit 2016, në lidhje me një depozitë prej 43.000 eurosh, në emër të bashkëshortes së tij si person fizik, konkluzion i cili përcaktoi vendimmarrjen. Rezulton se Komisioni i ka kaluar barrën e provës për këtë aspekt, sipas arsyetimit që do të shtjellohet në vijim të këtij vendimi gjatë trajtimit të shkakut ankimor respektiv.

---

<sup>7</sup> Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore datë 04.07.2022, subjekti ka depozituar në seancë, aktin e ekspertimit të hartuar nga një auditues ligjor i pajtuar prej tij.

<sup>8</sup> Në pikën 84 të prapësimeve kundër rezultateve të hetimit, subjekti ka pohuar se, me ndihmën e një audituesi ligjor, ka analizuar pasqyrat financiare.

8. Pasi mori në shqyrtim çështjen në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja “c” e ligjit 49/2012, i ndryshuar,<sup>9</sup> trupi gjykues vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, për të dëgjuar subjektin. Në seancën gjyqësore publike, të zhvilluar në datën 16.06.2025, trupi gjykues i drejtoi subjektit disa pyetje në lidhje me apartamentin në pronësi të bashkëshortes së tij, si edhe për depozitën me vlerë 43.000 euro, në emër të personit fizik të bashkëshortes. Për këtë të fundit, subjektit iu kërkua të shpjegojë dinamikën e veprimeve të kryera në drejtim të ekonomisë familjare dhe në kahun e kundërt, e konkretisht ,për transfertën e vitit 2016, nga llogaria e bashkëshortes si individ, te personi fizik, si edhe për mospasqyrimin e kësaj transferte në pasqyrat financiare të personit fizik. Po ashtu, subjekti u pyet edhe për një apartament të blerë në vitin 2018, pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, me burim krijimi depozitën objekt ankimi e shqyrtimi. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.
9. Trupi gjykues i njoftoi subjektin vendimin për mospranimin e kërkesës për marrjen në cilësinë e provës të akteve të dorëzuara me ankimin, me arsyetimin se nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 ndërsa akti i ekspertimit i audituesit të pajtuar prej subjektit u administrua si pjesë përbërëse e argumenteve që parashtrohen në ankim lidhur me çështjet financiare të kontrollit të kriterit të pasurisë.

## ***B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit***

### *B.1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale*

10. Subjekti i rivlerësimit pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e mbrojtur nga neni 6 i KEDNj-së, me argumentet e referuara më sipër, në rubrikën ku janë përmbledhur shkaqet e ankimit me natyrë “garancitë për proces të rregullt ligjor”. Mbështetur në to, subjekti argumenton se procesi i zhvilluar në Komision dhe aktet e prodhuara gjatë tij, përfshirë vendimmarrjet e ndërmjetme dhe ai përfundimtar, janë të pavlefshme, pasi janë kryer e marrë nga një gjykatë e formuar jo sipas ligjit. Komisioni i ka kaluar barrë prove të paarsyeshme në disa raste, ndërsa nuk i ka kaluar fare barrë prove për disa konstatime me të cilat është njohur vetëm pas publikimit të vendimit përfundimtar. Është “dënuar” administrativisht “pa faj”, në lidhje me pamundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes për të krijuar shumat e dhuruara asaj, përpara martesës me subjektin. Kjo pamjaftueshmëri, edhe sikur të provohet, nuk i përket subjektit dhe as ka lidhje me pasuritë e tij e as nuk mund të shërbejë si shkak ligjor për shkarkimin e tij nga detyra.
11. Nga analiza e akteve në fashikull nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar grupin e mësipërm të pretendimeve. Ky konkluzion mban në konsideratë qoftë sa rezulton nga verifikimi kryesisht i kryer në Kolegj, por edhe nga analiza e kryer për shkak të shkaqeve të ankimit. Së dyti, por jo për nga rëndësia, ky argument ngrihet për herë të parë me ankimin. Qoftë gjatë hetimit administrativ apo edhe në seancën dëgjimore në

---

<sup>9</sup> Neni 51, pika 1. Parashikon: “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: [...] c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë. 2. [...]”.

Komision, subjekti nuk ka pretenduar ndonjë shkelje të drejtash kushtetuese, konventore dhe ligjore. Për rrjedhojë, ngritja e këtyre pretendimeve rishtaz, në fazën e ankimit, shihet si “përprjekje” e subjektit për t’i dhënë procesit të tij të rivlerësimit një konotacion “paligjshmërie”. Gjithsesi, edhe duke abstraguuar nga ky konstatim, trupi gjykues konstatoi nga kontrolli i ushtruar në Kolegj, se procesi i rivlerësimit ndaj subjektit është kryer në përputhje me parimet kushtetuese të procesit të rregullt dhe ato të përcaktuara në nenet 6 dhe 7 të KEDNj-së, sikurse edhe me parimet themelore të procesit të rivlerësimit. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

11.1. Trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson të pabazuara të dyja pretendimet sipas të cilave subjektit i është shkëlur e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, për shkak se disa prej anëtarëve të trupit të tij gjykues nuk përmbushin kriteret e zgjedhshmërisë apo sepse trupi gjykues i Komisionit ka kryer funksione të dubluara, të spektrit hetimor dhe gjyqësor. Argumentet që lidhen me mënyrën se si funksionon Komisioni kanë gjetur përgjigje shteruese dhe përputhshmërinë e tyre me garancitë konventore në çështjen e GjEDNj-së, “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”. Ai vendim ka hyrë në fuqi mbi një vit përpara vendimit objekt ankimi të Komisionit dhe 16 muaj përpara se subjekti të përcillte ankimin objekt shqyrtimi. Mënyra e funksionimit të Komisionit ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese dhe të përputhshmërisë me parimet konventore të procesit të rregullt, sipas nenit 6 të KEDNj-së. Përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNj-së, është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese dhe është konfirmuar edhe nga GjEDNj-ja, në vendimin “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, në të cilin nuk u konstatuan shkelje të nenit 6/1 të KEDNj-së, lidhur me mënyrën e funksionimit të organeve të rivlerësimit. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera, në çështjet “Morel kundër Francës”, “Hauschildt kundër Danimarkës” etj., si edhe në vendimin që i përket “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, edhe Kolegji ka konsoliduar qëndrimin se nuk përbën cenim të parimit të paanësisë dhe, për rrjedhojë, as të procesit të rregullt ligjor, hetimi administrativ dhe vendimmarrja nga i njëjti trup gjykues.

11.2. Përpos këtij fakti, trupi gjykues i Kolegjit rikonfirmon sa është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit për kriteret e zgjedhshmërisë të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, nën dritën e natyrës *sui generis* të procesit të rivlerësimit dhe qëllimit të ligjvënësit për të zgjedhur procedura të mirëpërcaktuara nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji i posaçëm nr. 84/2016. Gjithashtu, në vendime të mëparshme,<sup>10</sup> Kolegji ka nënvizuar garancinë që ofron Kolegji, edhe nëse do të pranohej [apo prezumohej e provuar] që një ndër komisionerët ka qenë në kushtet e pazgjedhshmërisë, për sa kohë vendimi i Komisionit i nënshtrohet kontrollit shterues në Kolegj. Vetë ekzistenca e Kolegjit, si garancia gjyqësore fundore e procesit, sikurse edhe kontrolli i shtuar i vendimit të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit, përbëjnë një garanci me efekt zgjidhjeje efektive shëruese, të çdo defekti të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit apo edhe të konstatuar nga vetë Kolegji. Së fundmi, nga aktet rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me përbërjen e trupit gjykues, nuk rezulton të ketë kontestuar gjykimin nga ai trup gjykues

---

<sup>10</sup> Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 43/2022 (JR), paragrafi 14.2.i – iv, që i përket s. r. H. M.

apo të ketë ngritur pretendime mbi mospërbushjen e kushteve të zgjedhshmërisë të ndonjërit prej anëtarëve.

11.3. Në vijim, duke ndjekur rendin e argumenteve të potencuara nga subjekti, edhe duke abstraguuar nga konstatimi që subjekti nuk konkretizon në çfarë mënyre është paragjykuar nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit thekson me rëndësi për çështjen një analizë të qasjes së subjektit për paragjykimin e çështjes. Referuar pikës 85 të ankimit vërehet qartazi se subjekti i rivlerësimit e sheh paragjykimin e çështjes të lidhur me konkluzionet përfundimtare, të cilat sipas tij janë tërësisht të gabuara dhe të paragjykuara, sepse nuk janë rrjedhojë e vlerësimit të drejtë e të paanshëm të shpjegimeve dhe provave të paraqitura në kuadër të barrës së provës. Ky pretendim është i pambështetur në ligj, pasi ka lidhje me vlerësimin e provave, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 49,<sup>11</sup> të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 81<sup>12</sup> të Kodit të Procedurës Administrative. Në raport me këto kërkesa ligjore, vlerësimi i Komisionit, jo domosdoshmërisht duhet të konfirmojë argumentet dhe qëndrimin e subjektit për çështje të caktuara, dhe në këtë kuptim, vlerësimi ndryshe nuk e bën Komisionin as subjektiv dhe as paragjykes në vendimmarrjen e tij.

11.4. Përpos që i paargumentuar dhe i pabazuar në ligj, ky pretendim rezulton edhe i pavërtetë. Në vendim nuk vërehet i shprehur apo i nënkuptuar ndonjë element paragjykes i Komisionit. Përkundrazi, Komisioni e ka favorizuar në mënyrë të konsiderueshme subjektin. Konkretisht:

(i) Për mundësinë financiare të krijimit të një prej automjeteve<sup>13</sup> të analizuara në mesin e të ardhurave të disponuara nga subjekti në kohën e blerjes së tij, Komisioni ka përfshirë burime të *padeklaruara* në deklaratën *vetting*, duke shtuar edhe kursimet nga *paga* e subjektit dhe e bashkëshortes, ndonëse subjekti vetë ka referuar *vetëm* të ardhurat nga *shitjet e tre automjeteve* të tjera.

(ii) Komisioni e ka vlerësuar pa probleme depozitën e kursimit në shumën 15.500 euro, krijuar në vitin 2017, duke njohur si burim të ligjshëm shumën “të dhuruara” në vitin 2011, nga babai, të cilat subjekti *nuk i ka deklaruar* si gjendje *cash* gjatë viteve 2011 – 2017.

(iii) Për apartamentin në kompleksin “{\*\*\*}” [Vlorë], Komisioni ka ndryshuar/anashkaluar e lënë pa përgjigje konstatimin në rezultatin paraprak të hetimit, sipas të cilit subjekti ishte në pamundësi financiare për shkak të balancës negative të burimeve të ligjshme në shumën (-) 2.015.030 lekë, duke e trajtuar në vendim vetëm në kontekstin e pyetjes nëse çmimi ka qenë preferencial.

(iv) Ndonëse Komisioni ka konstatuar se veprimet financiare të blerjes lirë e shitjes shtrenjtë të automjeteve iu mungon logjika financiare, nuk e ka shoqëruar dhe as cilësuar atë me ndonjë pasojë,

---

<sup>11</sup> Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: [...] Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...].

<sup>12</sup> Neni 81 i K. Pr. Administrative parashikon: [...] Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ [...].

<sup>13</sup> Automjeti i markës “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}.

përpos mospërfshirjes së vlerave të referuara në kontratat e shitjes, por vetëm ato të blerjes, të cilat gjithsesi mund të kenë diskutime në cilindo kah dhe në kushtet që automjetet amortizohen.

(v) Vlerësimi lidhur me kriterin e figurës, për të cilin, ndryshe nga grupi i punës i DSIK-së, materializuar në dy raporte me të dhëna, si pasojë e të cilave ai ishte vlerësuar i papërshtatshëm, me kontakte jorastësore e me marrëdhënie interesi me persona të përfshirë në krimin e organizuar, Komisioni ka konkluduar krejtësisht ndryshe, duke e gjetur subjektin të besueshëm në kontrollin e figurës. Nga vendimi dhe rezultatet e hetimit nuk rezultojnë qartësi për natyrën e kontakteve, më së paku apo përse ndërthurja e interesave nuk është konstatuar të jetë element i provuar.

**11.5.** Pas kontrollit të vendimit të Komisionit dhe procedurës së ndjekur në tërësi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe pretendimet me fokus rregullat për barrën e provës, parimin e kontradiktoritetit dhe të drejtën për një mbrojtje efektive e të drejtë, janë të pabazuara. Komisioni ka respektuar garancitë kushtetuese e konventore për proces kontradiktor dhe mbrojtje efektive. Nuk qëndron dhe është edhe i pakuptimtë pretendimi se subjekti është njohur me “shkakun më të rëndë”, mbi bazën e të cilit është marrë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, pas publikimit të vendimit përfundimtar, apo që Komisioni nuk i ka kaluar subjektit barrë prove lidhur me rezultatet e pritshme të procedurës administrative. Ky konkluzion mban në konsideratë sa vijon:

**11.5.i.** Subjekti pretendon se i është kaluar barrë prove e paarsyeshme lidhur me pamundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes së tij, për blerjen përpara lidhjes së martesës, të një apartamenti në Vlorë, që sipas tij përbën shkelje të rëndë të sigurisë juridike dhe mosdënimit pa faj, sanksionuar në nenin 7 të KEDNJ-së. Trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit se, nën dritën e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, organet e rivlerësimit kanë për detyrë të hetojnë për pasuri të dyshuara të fshehura të subjekteve të rivlerësimit. Hetimet e kryera gjatë procesit të rivlerësimit marrin rëndësi për të konfirmuar ose përjashtuar dyshimet për pasuri të subjekteve të rivlerësimit, të fshehura pas veprimeve juridike, që nga pikëpamja formale pasqyrojnë të tjera fakte e rrethana, sikurse mund të jetë edhe regjistrimi i një pasurie të paluajtshme në pronësi të personave të tretë. Në këtë kuptim, trupi gjykues i Kolegjit nuk e vlerëson të paarsyeshëm kalimin e barrës për të provuar të kundërtën e gjetjes për rezultatin financiar të prindërve të bashkëshortes së tij, për pasurinë e pretenduar. Nga ana tjetër, kjo pasuri nuk ka shërbyer në vetvete si shkak për dhënien e masës disiplinore, çka e bën të pavërtetë pretendimin se subjekti “është dënuar pa faj” për një pasuri që nuk i përket. Më në detaje, ky pretendim do të trajtohet në vijim të këtij vendimi, gjatë trajtimit të shkakut ankimor të kësaj pasurie. Për më tepër, mënyra se si subjekti e koncepton këtë argument nuk gjen zbatim në procedurën administrative, sikurse është procesi i rivlerësimit.

**11.5.ii.** Sa i përket pretendimit për moskalim të barrës së provës në lidhje me balancën financiare përkeqësuese mes rezultateve të hetimit dhe asaj në vendim, trupi gjykues vëren se, në pamje të parë, rezultojnë një diferencë prej 243.288 lekësh më e thellë në vendim. Konkretisht në vendim, Komisioni referon një balancë negative prej (-) 3.235.593 lekësh, kundrejt (-) 2.992.305 lekë, në rezultatet e hetimit. Ky ndryshim, që është rezultat i përmirësimit të analizës në vitin 2013 dhe i përkeqësimit në vitin 2016, rezultojnë të jetë për zëra, për të cilët subjektin i ka kaluar barra e provës e për të cilat ka dhënë shpjegime. Ky fakt nënkupton së pari që mundësia e tij për t’u mbrojtur

është shteruar parimisht. Siç do të shtjellohet në vijim, thelbi i pretendimit konsiston në moskuptimin e rezultateve të hetimit. Të kuptuarit ose jo i këtij rezultati nga ana e subjektit, nuk përbën cenim të së drejtës së tij për t'u mbrojtur, për sa kohë subjekti është shprehur se është ndihmuar nga një ekspert i fushës, e po ashtu, nuk ka pretenduar paqartësi apo vështirësi në të kuptuarit e raportit të rezultateve të hetimit dhe të analizës financiare.

**11.5.iii.** Nga ana tjetër, në kushtet që ankimi iu nënshtrua kontrollit të Kolegjit, subjekti u dëgjua në seancë publike në Kolegj dhe dha shpjegime edhe për këtë aspekt financiar dhe, sikurse arsyetohet në vijim gjerësisht, analiza financiare e korrektuar në Kolegj, përfundimisht, rezultoi me një balancë negative prej (-) 1.639.209 lekësh, nën vlerën e konstatuar në rezultatet e hetimit – që ishte vlera më e ulët – ky aspekt i ankimit konsiderohet i adresuar dhe i shteruar si pasojë e këtij vendimi. Më në detaje, ky pretendim do të trajtohet në vijim, në shkakun ankimor që lidhet me depozitën 43.000 euro, në emër të personit fizik të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

**11.5.iv.** Pretendimi se Komisioni, krahas gjetjeve, duhet t'i bënte me dije subjektit edhe rezultatin e pritshëm, nëse gjetjet konkrete do ta çonin drejt shkarkimit nga detyra, është po ashtu i pabazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në aktet nënligjore të miratuara nga Komisioni,<sup>14</sup> në jurisprudencën e GjEDNJ-së,<sup>15</sup> si edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>16</sup>. Konkretisht, dhe sikurse arsyetuar nga Kolegji në mënyrë të përsëritur, me barrën e provës njoftohen gjetjet, të cilat kanë arritur nivelin e provueshmërisë që përmbushin në këtë mënyrë edhe parashikimin nën dritën e nenit 87, pika 2, germa “ç” e ligjit nr. 44/2015<sup>17</sup>. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit për aspekte të ndryshme të tetë (8) çështjeve në kontrollin e pasurisë, përfshirë pasuritë e deklaruara nga bashkëshortja. Vlerësimet përfundimtare të Komisionit, si pasojë mund dhe duhet të bëhen vetëm pasi subjekti i rivlerësimit paraqet argumentet dhe provat mbështetëse. Nëse Komisioni do të konkludonte, që në fazën e hetimit, se gjetja konkrete do të çonte drejt një mase disiplinore, atëherë ai do të paragjykonte çështjen, pasi me kalimin e barrës së provës subjektit, mund të ndodhte që me provat e sjella, si gjatë hetimit apo edhe në seancën dëgjimore, mund të përmysej rezultati paraprak i hetimit.

**11.5.v.** Ndryshe nga sa pretendohet, subjektit i është garantuar e drejta për t'u mbrojtur, pasi informacioni që mori pas përfundimit të hetimit administrativ, nuk mund të argumentohet se nuk i ka mundësuar atij që të kuptonte seriozitetin e gjetjeve për të cilat i ka kaluar barra e provës. Për rrjedhojë, subjekti ishte tërësisht në dijeni të drejtimeve, për të cilat duhet të përgatiste mbrojtjen e prapësimet. Po ashtu, subjektit i janë respektuar garancitë kushtetuese për të njohur dhe për të aksesuar dokumentacionin e çështjes dhe metodologjinë e përdorur për kryerjen e analizës financiare, në mënyrë që të përgatiste mbrojtjen. Në përgjigje të pretendimit për rregulla të padrejta

---

<sup>14</sup> Pika 6 e rregullores së Komisionit, “Hapat proceduralë të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

<sup>15</sup> Vendimi i GjEDNJ-së për çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, pikat 330 dhe 332.

<sup>16</sup> Vendimi nr. 9/2018 (JR), datë 24.10.2018, paragrafi 54, që i përket s. r. A. Xhoxhaj, ndër të tjera.

<sup>17</sup> Kjo dispozitë parashikon: “[1.] Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar. 2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna: [...] ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës [...]”.

të procesit të rivlerësimit në përgjithësi, trupi gjykues çmon të rikonfirmojë se rregullat e procesit të rivlerësimit janë të mirëpërcaktuara në dispozitat e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, kanë kaluar testin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, sikurse edhe kanë gjetur analizë shteruese në vendimin e GjEDNj-së në çështjen kyç “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, nga aktet në dosje, rezulton se Komisioni ka vepruar në përputhje me rregullat e përcaktuara në këto dispozita ligjore dhe nuk vërehen situata, në të cilat Komisioni të ketë aplikuar rregulla të padrejta ndaj subjektit të rivlerësimit në veçanti.

**11.5.vi.** Nga ana tjetër, pretendimi se është cenuar parimi i sigurisë juridike si rezultat i përdorimit të termave “deklarim i pamjaftueshëm i të ardhurave” dhe “deklarim i pamjaftueshëm i pasurisë”, apo që këto koncepte nuk janë sqaruar nga ligji nr. 84/2016, është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit,<sup>18</sup> i cili tashmë ka konsoliduar qëndrimin mbi këtë çështje, se vetëm fakti i përdorimit të këtyre togfjalëshave në vendimin e Komisionit, pa vlerësuar kontekstin në të cilin kanë gjetur përdorim, si dhe kuptimin që i ka dhënë Komisioni nëpërmjet arsytimit të tij, nuk vlerësohet i mjaftueshëm për t’u ngritur në nivelin e një shkak ligjor, që mund të cenojë vlefshmërinë e vendimit të Komisionit.

**11.5.vii.** Pretendimi për cenim të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i mosaplikimit të parimit të “dyfishit të pasurisë së ligjshme”, ka marrë përgjigje shteruese në jurisprudencën e Kolegjit,<sup>19</sup> i cili ka konsoliduar qëndrimin se leximi harmonik i neneve 61, pika 3, dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, përcakton detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, në zbatim të përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues rikonfirmon, edhe në këtë rast, qëndrimin e deritanishëm se shkaqet që passjellin marrjen e masës disiplinore janë autonome dhe jo të kushtëzuara nga njëra-tjetra. Deklarimi i dyfishit të pasurisë është vetëm një ndër gjashtë situatat, për të cilat mund të merret masa disiplinore, ajo në të cilën organet e rivlerësimit nuk kanë diskrecion përpos shkarkimit automatik. Kjo mënyrë leximi e interpretimi e organeve të rivlerësimit ka kaluar tashmë edhe testin e kontrollit të kryer nga GjEDNj-ja, duke nisur nga çështja kyç “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, ndër të tjera, e cila ka lënë në fuqi vendimet e Kolegjit bazuar në këtë interpretim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky shkak ankimi është i pabazuar.

**11.5.viii.** Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit, se Komisioni është treguar subjektiv dhe ka përdorur një standard të ndryshëm për të, duke i rënduar pozitën në aspektin e vlerësimit të kriterit të pasurisë. Përpos sa potencuar më sipër për çfarë përbën *favorizim* të dukshëm në qasjen e Komisionit ndaj subjektit, në kushtet që subjekti nuk ka konkretizuar ku ekzaktësisht duket subjektivizmi dhe mungesa e paanësisë dhe e paragjyqimit, ky pretendim në fakt prezumohet se lidhet me zgjidhjen e çështjes dhe disponimin përfundimtar, me të cilin subjekti

---

<sup>18</sup> *Vendimet e Kolegjit: nr. 8, datë 07.04.2022, paragrafi nr. 19.5, që i përket s. r. E. H.; nr. 45, datë 17.11.2022, paragrafi nr. 17, që i përket s. r. J. N. etj.*

<sup>19</sup> *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 19, datë 26.07.2019, paragrafi 22.15, që i përket subjektit Xh. Z.; nr. 1/2021, paragrafi 20-20.1, që i përket subjektit A. S.; nr. 16, datë 26.05.2022, paragrafi 23, për subjektin M. V.; nr. 33, datë 29.07.2022, paragrafi 19 për subjektin A. Xh. etj.*

nuk është dakord. Nga ana tjetër, paralelizmi me subjektet e tjera është i pamundur në vetvete të paraqesë qartësi argumentimi, përveçse edhe nuk është konkretizuar.

**11.5.ix.** Së fundmi, i vetmi argument në drejtim të sa më sipër, që rezulton të jetë konkret, lidhet me pasurinë e prindërve të bashkëshortes, në Vlorë. Subjekti potencon se Kolegji ka vlerësuar në vendime të subjekteve të tjera se problematikat e konstatuara në pasuri të krijuara përpara martesë nuk shërbejnë si shkaqe të pavarura për shkarkim nga detyra. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, edhe në rastin e subjektit, problematikat që rezultuan për apartamentin në pronësi të bashkëshortes, nuk kanë qenë shkaku kryesor për të cilin është marrë vendimi i shkarkimit, ndonëse Komisioni ka hetuar fillimisht për fshehje pasurie. Këto konstatime, Komisioni i ka mbajtur në konsideratë në kontekstin e besueshmërisë së subjektit në kontrollin e kriterit të pasurisë, që përbën vetëm një ndër aspektet mbi të cilat ky nocion është analizuar.

**11.5.x.** Edhe pretendimi se vendimi i Komisionit nuk është arsyetuar mjaftueshëm, është i pabazuar. Vendimi i Komisionit rezulton të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, pasi pasqyron të gjitha pjesët përbërëse: hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese.<sup>20</sup> Edhe këto tri pjesë, në nënpjesët e tyre përmbajnë të gjitha rubrikat e parashikuara nga ligji. Së fundmi, në drejtim të përmbajtjes, në vendimin e Komisionit janë të qarta arsyet mbi të cilat është mbështetur zgjidhja përfundimtare dhe baza mbi të cilën është marrë masa disiplinore. Nga shqyrtimi i ankimit, trupi gjykues vëren se mungesën e analizës, subjekti i rivlerësimit e lidh me apartamentin e bashkëshortes, të krijuar përpara lidhjes së martesës, për të cilin Komisioni nuk ka bërë arsyetim se përse ka vendosur të mbajë në konsideratë situatën financiare të prindërve të bashkëshortes së tij për blerjen e këtij apartamenti, ndërkohë që po vetë ka vlerësuar se problematikat e konstatuara për këtë pasuri nuk janë të mjaftueshme për të ngarkuar me përgjegjësi subjektin. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se arsyetimi i Komisionit është i mangët në kushtet që ndërsa fillimisht konkludon [në paragrafin 60] se një mungesë burimesh, thuajse sa e gjithë vlera e apartamentit, nuk do t'i ngarkohet subjektit si pasojë në proces, nën dritën e proporcionalitetit, ndërsa më tej [në paragrafin 109] referohet se kjo balancë negative do të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të pasurisë. Ndonëse evidenton mungesë arsyetimi mbi nevojën për ta bërë problematikën në fjalë pjesë të vlerësimit tërësor të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky konstatim nuk e bën të cenueshëm vendimin objekt ankimi, në kushtet që kjo pasuri nuk është përfshirë në analizën e përgjithshme financiare të subjektit, nuk e rëndon pozitën e tij financiare dhe në vetvete, nuk ka shërbyer si shkak për vlerësimin final. Ky vlerësim i jep përgjigje edhe pretendimit se subjekti është “dënuar” administrativisht “pa faj”, në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare të prindërve të bashkëshortes për të krijuar shumat e dhuruara asaj përpara martesës me subjektin.

---

<sup>20</sup> “[2.] Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese. 3. Hyrja e vendimit përmban: a) emërtimin zyrtar të Komisionit; b) trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësin administrativ; c) orën dhe vendin e vendimit të dhënë; ç) emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit, si dhe përfaqësuesve të tij; d) mendimin e subjektit të rivlerësimit dhe/ose të përfaqësuesit të tij. 4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet; c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështeten vendimi. 5. Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban: a) alternativën që ka vendosur trupi gjykues; b) nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore; c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij”.

## **B.2. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë**

### **B.2.1 Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e pasurisë**

#### **I. Automjetet “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, blerë më datë 27.10.2015**

12. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* automjetin objekt shqyrtimi me vlerë 14.000 euro, të blerë me kontratë të datës 27.10.2015, si edhe vlerën 397.097 lekë, të paguar për zhdoganimin e tij. Si burim, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e tre (3) automjeteve dhe specifikuar konkretisht: (i) shumën 400.000 lekë nga shitja e automjetit [me targë {\*\*\*}], me kontratën datë 06.05.2015; (ii) shumën 1.000.000 lekë nga shitja e automjetit “Mercedes-Benz” [me targë {\*\*\*}], me kontratën datë 09.06.2015; (iii) shumën 1.000.000 lekë nga shitja e automjetit “BMW”, [me targë {\*\*\*}], me kontratën datë 20.10.2015. Në deklaratën periodike për vitin 2015, ndryshe nga deklaratat *vetting*, janë deklaruar *kursimet* si burim krijimi për blerjen e mjetit dhe për pagimin e detyrimit doganor.

12.1. Për këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, për shkak të një balance negative në vlerën prej (-) 834.039 lekësh, *për të riplotësuar kursimet cash*, deri në fund të vitit 2015. Në këtë konkluzion, Komisioni ka mbajtur në konsideratë që: (i) nuk ka logjikë ekonomike në transaksionet e subjektit të rivlerësimit, duke shitur gjatë vitit 2015, tre (3) automjete me çmime më të larta sesa ato të blerjes, pas vitesh të tëra përdorimi dhe amortizimi, të cilat ngrenë dyshime për veprime fiktive të kryera për të rritur në mënyrë artificiale të ardhurat dhe për të justifikuar blerjen më pas të automjetit të ri; (ii) të ardhurat nga shitja e këtyre mjeteve nuk konsiderohen e ardhur me burim të ligjshëm dhe nuk janë përfshirë në analizë, meqenëse nuk është paguar tatimi mbi fitimin nga shitja; (iii) mangësitë e konstatuara në rezultatet e hetimit në lidhje me burimet që shërbyen për krijimin e pasurisë<sup>21</sup> u vlerësuan si të shuara/të zeruara pas barrës së provës; (iv) nga analiza financiare e vitit 2015, subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare, rezultat i cili, *në vetvete*, nuk është i mjaftueshëm për të aplikuar shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

12.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion, duke pretenduar se ka pasur aftësi paguese për blerjen e automjetit objekt vlerësimi me të ardhurat e realizuara nga shitja e tre automjeteve të mëparshme dhe nuk ka pasur detyrim ligjor për derdhjen e tatimeve, pasi ky zë nuk është e ardhur e tatueshme për individët e paregjistruar në organet tatimore. Shitja më shtrenjtë e një sendi të luajtshëm të mirëmbajtur dhe mbi të cilin ai ka kryer investime, që i kanë rritur vlerën, nuk bie ndesh me parimet e ekonomisë së tregut. Subjekti kërkoi përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara të të ardhurave nga shitja e automjeteve të mëparshme, sipas çmimeve kontraktore ose, së paku, me një vlerë që përfshin vlerën e blerjes dhe atë të investimit.

---

<sup>21</sup> Referuar pikës 24 të vendimit objekt shqyrtimi, në rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 2.047.318 lekë, për të realizuar blerjen në vitin 2015, të automjetit objekt kontrolli, si dhe për të përballuar shpenzimet dhe investimet e kryera në llogaritë bankare, deri në datën 18.11.2015.

13. Nga kontrolli në Kolegj, i analizës financiare për vitin 2015, konfirmohet minimalisht balanca negative e konstatuar nga Komisioni për mbulimin e shpenzimeve dhe për krijimin e kursimeve të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, në funksion të blerjes së automjetit “Mercedes- Benz, me targa {\*\*\*}, në tetor 2015. Sikurse në Komision, edhe në vlerësimin e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit, konfirmohet mungesa e logjikës ekonomike të shitjeve të tre automjeteve në vlerë shumë më të lartë se blerja, pas përdorimit të tyre nga subjekti, që varion nga katër (4) muaj e deri në 14 vjet. Ky konkluzion mbështetet në sa vijon:

13.1. Trupi gjykues vëren se analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke konstatuar mungesë logjike ekonomike në *blerjen lirë e shitjen shtrenjtë* të automjeteve, është e bazuar, ndonëse vlerësohet i gabuar argumentimi i mbështetur në mospagimin e detyrimeve tatimore. Nga panorama e veprimeve të deklaruara nga subjekti, trupi gjykues arriti në përfundimin që ato përkojnë vetëm me nevojën e tij për të dokumentuar gjenerim të ardhurash financiare dhe nuk janë të besueshme si pasqyrim i së vërtetës, pasi bien ndesh me logjikën e thjeshtë ekonomike të amortizimit që pësojnë automjetet ndër vite dhe gjatë përdorimit. Pretendimet e subjektit, se vlera e automjeteve rritet gjatë kohës që ato janë në pronësi të tij, “si rezultat i mirëmbajtjes dhe i shërbimeve të vazhdueshme”, mbetën në nivel deklarativ. Shpenzime/investime të atilla që do të rrisnin vlerën e automjetit [pavarësisht përdorimit], në një rast edhe në *disafishin* e vlerës së paguar për blerjen, nuk janë dokumentuar në asnjë formë e as kanë lënë gjurmë në deklaratimet periodike të viteve përkatëse, përfshirë edhe atë të vitit 2015, që të mund të përdorej si provë.

13.2. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se, ndonëse Komisioni arsyeton se iu mungon logjika financiare transaksioneve të blerjes lirë e shitjes shtrenjtë të tre automjeteve nga subjekti, në konkluzion, ky aspekt nuk rezulton që të jetë shoqëruar me ndonjë pasojë, përpos mospërfshirjes së vlerave të referuara në kontratat e shitjes në analizën financiare, por vetëm të vlerës së blerjes, e cila gjithsesi mund të jetë e diskutueshme për saktësinë e saj, në konsideratë të faktit se automjeti amortizohet me përdorimin. Ky konstatim paraqet rëndësi jo vetëm në drejtim të saktësisimit të situatës që rezulton nga vendimi i Komisionit, por dhe për të theksuar që, ndryshe nga sa pretendon subjekti, rivlerësimi i kryer për të nuk paraqet asnjë aspekt paragjykimi apo tendencioziteti. Përkundrazi, Komisioni ka qenë favorizues dhe ka pranuar pa argumentim deklaratimet kontradiktore të subjektit për burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, sikurse edhe ka shtuar edhe burime të padeklaruara dhe as të kërkuara prej subjektit, siç janë kursimet e prindërve, në kundërshtim me sa ai ka referuar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, apo me përgjigjet e pyetësorit nr. 2. Konkretisht, ndërsa në deklaratën *vetting* dhe në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar si burime vetëm të ardhurat nga *shitja* e tre (3) automjeteve në pronësi të mëparshme të tij, në prapësim të rezultateve të hetimit administrativ, ai ka referuar si burim *kursimet*, sikurse në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015. Në ankim,<sup>22</sup> subjekti i është rikthyer deklaratimit në deklaratën *vetting* dhe në pyetësor, duke referuar vetëm shitjen e automjeteve.

13.3. Në vendim, Komisioni po ashtu duket të mos ketë dhënë qëndrim lidhur me balancën negative prej rreth 2 milionë lekësh, për krijimin e automjetit në vitin 2015, duke zgjedhur të pranojë

---

<sup>22</sup> Në pikën nr. 86 të ankimit.

pretendimet gjatë procesit të hetimit administrativ për përdorim e zëvendësim të likuiditeteve *cash*, në kundërshtim me qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit, në kushtet që këto burime nuk identifikohen në deklaratat periodike apo në atë *vetting*.

13.4. Në përmbledhje të sa më sipër, në kushtet që balanca negative e vitit 2015 konfirmohet edhe në analizën në Kolegji, ky konkluzion i vendimit objekt ankimi u gjet i bazuar. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga pikat 1 dhe 3 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe germa “b” e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

13.5. Ky konkluzion i Kolegjit bazohet në problematikat që u evidentuan qoftë për burimet e krijimit të automjetit, pakësimin të kursimeve dhe zëvendësimin të tyre, në fund të vitit 2015, por edhe të mungesës së besueshmërisë së shpjegimeve të subjektit, shtjelluar më sipër dhe në vijim. Fillimisht, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje qasjen *favorizuese* të Komisionit në lidhje me burimet e pranuar në analizën financiare të automjetit objekt shqyrtimi. Konkretisht, ndërsa në deklaratën *vetting*, në pyetësorin nr. 1 dhe, së fundmi, edhe në ankim, deklarohen si burime *vetëm të ardhurat nga shitja e tre automjeteve* në pronësi të subjektit, në deklaratën periodike për vitin 2015, si burime deklarohen vetëm *kursimet*. Këto mospërputhje në deklarime, nuk janë ngritur nga Komisioni në nivelin e gjetjeve gjatë hetimit në asnjë çast. Përkundrazi, krahas tri burimeve nga shitja e automjeteve të deklaruar në deklaratën *vetting*, Komisioni ka zgjedhur të përfshijë në analizën e burimeve financiare të përdorura nga subjekti edhe burime të padeklaruar prej tij, sikurse të ardhurat nga *pagat* e subjektit të rivlerësimit dhe ato nga *aktiviteti i bashkëshortes* së tij, për harkun kohor janar 2015 – 18.11.2015. Ky konstatim silltet në vëmendje si një dëshmi kundrejt pretendimit të subjektit, se Komisioni është treguar i njëanshëm dhe paragjykues në procesin e rivlerësimit të ndjekur ndaj tij. Megjithatë, në mbrojtje të garancive procedurale të subjektit në këtë proces, trupi gjykues i Kolegjit e bazoi analizën financiare në *të njëjtat burime* sikurse dhe në Komision, analizuar në vijim.

13.6. Meqenëse në analizë përfshihen katër (4) automjete, tre (3) prej të cilëve me elemente *identike* shifrore të targave dhe të së njëjtës markë<sup>23</sup>, trupi gjykues çmon t’i referojë elementet identifikuese për qartësi. Së pari, gjatë vitit 2015, subjekti ka pasur në pronësi katër automjete të ndryshme: (i) automjetin me targë {\*\*\*}, blerë në dhjetor 2001 dhe shitur në 06.06.2015; (ii) automjetin me targë {\*\*\*}, blerë në datën 25.09.2008 dhe shitur më 09.06.2015; (iii) automjetin BMW, me targë {\*\*\*}, blerë më 09.06.2015 dhe shitur më 20.10.2015 dhe, së fundmi (iv) automjetin e deklaruar në deklaratën *vetting*, me targë {\*\*\*}, blerë më datë 27.10.2015. Dy prej tyre kanë qenë njëkohësisht në pronësi të tij në qershor 2015 dhe janë shitur në harkun kohor disaditor. Automjeti i tretë është blerë ditën kur është shitur automjeti i dytë dhe shitur në tetor 2015, disa ditë përpara blerjes së automjetit objekt analize, deklaruar në deklaratën *vetting*. Pas përdorimit gjatë periudhash që variojnë nga 13.5 vjet, në 4 muaj, secili prej mjeteve është shitur me çmim mbi dyfish më të lartë sesa ai i blerjes. Në vijim, analiza e Kolegjit mbi bazën e shkaqeve të ankimit.

---

<sup>23</sup> Nga të cilët, tre të markës “Mercedes-Benz” dhe një “BMW”.

*I. A. Shuma 400.000 lekë, nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*}*

13.7. Ky automjet është blerë në vitin 2001, nga subjekti i rivlerësimit, me kontratë noteriale<sup>24</sup> datë 28.12.2001, kundrejt çmimit 50.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në deklaratën periodike për vitin 2003, subjekti ka deklaruar blerjen kundrejt çmimit *300.000 lekë*. Pas 14 viteve, subjekti e ka shitur këtë automjet kundrejt shumës 400.000 lekë, me kontratë noteriale<sup>25</sup> të datës 06.06.2015. Edhe kjo vlerë është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

13.8. Komisioni ka njohur si të ligjshme vetëm shumën 50.000 lekë të blerjes, sipas kontratës dhe jo vlerat 300.000 lekë, të deklaruara në deklaratën periodike për vitin 2003 apo 400.000 lekë sipas kontratës së shitjes në vitin 2015. Në këtë konkluzion, Komisioni ka mbajtur në konsideratë që: (i) ka mospërputhje ndërmjet vlerës së pasurisë të deklaruar në DIPP-në 2003 dhe vlerës së përcaktuar në kontratën e shitblerjes së vitit 2001; (ii) konstatohet mungesë logjike ekonomike në shitjen e këtij automjeti me një çmim disa herë më të lartë se çmimi i blerjes, sidomos nëse konsiderohet amortizimi fizik gjatë 14 viteve përdorim, çka ngre dyshime për veprime fiktive të kryera për të rritur në mënyrë artificiale të ardhurat dhe për të justifikuar më pas blerjen e automjetit të ri; (iii) të ardhurat nga shitja e këtij automjeti, nuk mund të konsiderohen me burim të ligjshëm, meqenëse subjekti nuk ka paguar detyrimet përkatëse tatimore.

13.9. Në ankim, subjekti potencon të njëjtat pretendime me ato të ngritura gjatë hetimit administrativ dhe prapësimet kundër rezultateve të hetimit. Konkretisht, mospërputhja e çmimit mes kontratës dhe deklaratës periodike, sipas tij, ka për shkas riparimet në vlerën 250.000 lekë, që ai ka financuar për ta vënë “në gjendje pune” automjetin. Shitja në vlerën 400.000 lekë, në vitin 2015, ka ndodhur pasi automjeti është rritur në vlerë si “relike”, duke qenë prodhim i vitit 1983, në gjendje shumë të mirë teknike dhe fizike. Për detyrimet tatimore, subjekti ka potencuar sa është përmbledhur më sipër, për mungesën e detyrimit ligjor. Bazuar në këto argumente, subjekti i kërkon Kolegjit që në analizën financiare të përfshijë të ardhurat nga shitja, në shumën 400.000 lekë ose, së paku, në vlerën 300.000 lekë, sipas deklaratës periodike të vitit 2003, që përfshin edhe vlerën e investimit prej 250.000 lekë [sikundër veprohet për analogji me shpenzimet doganore]. Këto pretendime nuk janë mbështetur me dokumentacion provues.

13.10. Trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi këto pretendime të pabazuara në akte dhe në ligj. Pretendimi për një *investim të menjëhershëm*, përpara vënies në përdorim, duke kryer riparime të ndryshme, në vlerën 250.000 lekë, *për ta bërë mjetin në gjendje pune*, nuk gjen mbështetje në dokumentacionin e depozituar. Në përmbajtje të kontratës së shitblerjes, nuk rezulton të jetë përshkruar ndonjë defekt apo e metë e automjetit dhe as ndonjë rezervë për sa i takon gjendjes teknike të mjetit. E kundërta rezulton në kontratë: të dyja palët kanë deklaruar se mjeti është dorëzuar në gjendje të rregullt teknike. Po kështu, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument, qoftë edhe rrethanor të kohës, për të provuar investime mbi automjetin. Për rrjedhojë, këto pretendime mbetën të natyrës tejet deklarative. Edhe nëse abstragohet nga sa më sipër e të prezumohet vlera 300.000 lekë, sipas deklaratës periodike për vitin 2003, hetimi i Komisionit ka qenë i mangët në

<sup>24</sup> Nr. {\*\*\*} regj., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.12.2001.

<sup>25</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.06.2015.

tërësi, pasi nuk rezulton që të ketë shqyrtuar nëse subjekti ka pasur mundësi të financonte një investim në vlerën 300.000 lekë. Tashmë, Kolegji ka pranuar efektin zinxhir që prodhon pamjaftueshmëria për krijimin e një pasurie dhe ndikimin që jep tek të ardhurat nga shitja e saj, të cilat nuk konsiderohen burim i ligjshëm për pasurinë e re të krijuar nëpërmjet tyre. Nga analiza e kryer në Kolegji, për qëllim të shterimit të të gjitha pyetjeve të mundshme, subjekti rezulton me një balancë negative prej (-) 18.502 lekësh.

**13.11.** Pretendimi se ky automjet është shitur kundrejt vlerës 400.000 lekë, në vitin 2015, meqenëse tashmë flitej për një “relike”, ka mbetur në nivel deklarativ. Subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion mbështetës: (a) shpenzime/investime që kanë rritur vlerën e pronës dhe (b) nuk depozitoi ndonjë dokument që provon interesin e blerësit [z. B. B.] për grumbullim të automjeteve relike/retro. Ndonëse me më pak peshë, por gjithsesi si aspekt që do të shtonte besueshmërinë, subjekti nuk ka provuar me dokumentacion asnjë transaksion, nëpërmjet të cilit ai ka fituar këtë shumë – palët janë shlyer jashtë zyrës noteriale dhe nuk ka asnjë depozitë që përkon në kohë me veprimet në fjalë. Në këto kushte, kërkimi i subjektit për të përfshirë në analizën financiare shumën 400.000 lekë, sipas çmimit të përcaktuar në kontratën e shitjes datë 06.06.2015, rezulton i pambështetur në dokumentacion.

**13.12.** Nga ana tjetër, rezulton i drejtë pretendimi i subjektit, se fitimi i realizuar nga shitja e automjeteve, nuk është e ardhur e tatueshme, në bazë të ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Në jurisprudencën e tij,<sup>26</sup> Kolegji ka kushtëzuar përfshirjen e të ardhurave nga shitja e automjeteve pa e lidhur me pagimin e tatimeve, *vetëm* me dyshime *mbi fiktivitetin* e çmimit të blerjes apo të shitjes së tij. Bazuar në këtë qëndrim të Kolegjit dhe në kushtet që Komisioni ka konkluduar për çmime *fiktive* në veprimet juridike të automjetit në fjalë, trupi gjykues vlerësoi se, në analizën financiare të vitit 2015, duhet përfshirë vetëm vlera 50.000 lekë, e përcaktuar në kontratën nëpërmjet së cilës subjekti ka blerë këtë pasuri, duke u bazuar në argumentin e fiktivitetit të çmimit të shitjes dhe jo atij për mospagim të tatimeve, të arsyetuar nga Komisioni.

*I. B. Shuma 1.000.000 lekë, nga shitja e mjetit “Mercedes-Benz”, me targë {\*\*\*}*

**13.13.** Burimi i dytë i deklaruar për blerjen e automjetit objekt analize në deklaratën *vetting* është shuma 1.000.000 lekë, nga shitja e një automjeti të dytë. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës *vetting*, rezulton që subjekti e ka blerë këtë automjet në datën 25.09.2008, nga një person juridik i huaj, kundrejt çmimit 4.000 euro,<sup>27</sup> dhe ka paguar<sup>28</sup> vlerën e doganës 339.521 lekë, me deklaratën doganore të datës 01.10.2008. Me kontratën noteriale të shitjes datë 09.06.2015 [pas 7 vitesh përdorim], subjekti i rivlerësimit ia ka shitur këtë automjet një individit [z. Y. A.], kundrejt shumës 1.000.000 lekë, e likuiduar e gjitha jashtë zyrës noteriale. Bazuar në këto akte, vlera totale e përfitimit nga shitja e këtij automjeti, sipas përlllogaritjes së Komisionit, ka qenë 832.251 lekë.

<sup>26</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 26, datë 03.07.2023, pika 12.5, i subjektit të rivlerësimit G. Xh.

<sup>27</sup> Vlera e automjetit, prej 4.000 eurosh, në bazë të kursit të këmbimit të kohës prej 121.7 lekë, të specifikuar në deklaratën doganore të datës 01.10.2008, konvertohet në 486.800 lekë.

<sup>28</sup> Në DIPP-në 2008, subjekti ka deklaruar se ka paguar për doganën e mjetit, vlerën 339.521 lekë.

Në deklaratën periodike të kohës [për vitin 2008], përpos vlerës së shpenzuar për blerjen dhe zhdoganimin, subjekti nuk ka deklaruar burimet e krijimit të kësaj pasurie. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ai është shprehur se si burim për blerjen e automjetit kanë shërbyer *kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes*.

**13.14.** Në rezultatet e hetimit dhe në vendim, Komisioni ka konkluduar në të njëjtën linjë, si edhe për automjetin tjetër, në kushtet që edhe këtë automjet subjekti e ka shitur me fitim, pas shtatë (7) vitesh përdorimi e amortizimi, dhe dyshimet për veprime fiktive të kryera për të rritur në mënyrë artificiale të ardhurat dhe për të justifikuar blerjen e automjetit të ri. Pavarësisht nga mundësia e krijimit të pasurisë, sipas analizës së Komisionit, të ardhurat në shumën 832.251 lekë nuk janë përfshirë me argumentin që lidhet me mospagimin e detyrimit tatimor në shitje. Meqenëse subjekti nuk ka deklaruar ndonjë gjendje *cash*-i në asnjë deklaratë periodike deri në vitin 2008, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare: (i) shumën 725.000 lekë, të tërhequr nga llogaritë e pagave, deri në datën 25.09.2008;<sup>29</sup> (ii) të ardhurat nga pensionet e prindërve të subjektit, në shumën 190.652 lekë; (iii) si edhe fitimin neto prej 1.016.412 lekësh, në vitin 2008, nga aktiviteti i personit fizik në emër të nënës së subjektit. Në bazë të kësaj analize financiare, subjekti rezultoi në Komision me mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare në shumën (+) 80.437 lekë, për likuidimin e shpenzimeve të blerjes dhe zhdoganimit të këtij mjeti, më datë 25.09.2008.

**13.15.** Në ankim, subjekti kundërshton konkluzionet e mësipërme me të njëjtat argumente të shpjeguara gjatë hetimit administrativ, sikurse edhe për automjetin tjetër. Ai potencon se gjendja fizike dhe teknike e mjetit ka qenë shumë e mirë, si rezultat i mirëmbajtjes dhe i shërbimeve të vazhdueshme, të cilat janë kryer me para në dorë, pa fatura, në pika servisi të ndryshme. Subjekti nuk disponon dokumente. Përfundimisht, subjekti kërkon që në analizën financiare të blerjes së automjetit, Kolegji të përfshijë të ardhurat në shumën 1.000.000 lekë, sipas çmimit të përcaktuar në kontratën e shitjes të vitit 2015.

**13.16.** Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e mësipërme janë të pabazuara. Duke mbajtur në konsideratë përdorimin afatgjatë, që si rregull e amortizon automjetin, nuk ka logjikë ekonomike shitja me çmim më të lartë se ai i blerjes. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se çmimi i shitjes, prej 1.000.000 lekësh, bën kuptim në rrethanat konkrete vetëm si veprim fiktiv, i kryer nga subjekti për të rritur në mënyrë artificiale të ardhurat dhe për të justifikuar më pas blerjen e automjetit të ri. Për rrjedhojë, edhe në analizën e burimeve financiare të ligjshme të disponuara nga subjekti, trupi gjykues i Kolegjit nuk përfshiu shumën e pretenduar të fituar nga shitja. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mori në konsideratë edhe faktin që subjekti nuk provoi në asnjë formë investimet e kryera, qoftë edhe si shpenzime. Në kushtet që subjekti pretendon të ketë fituar një vlerë thujse sa dyfishi i vlerës së shpenzuar për blerjen e automjetit, investimet që do të balanconin amortizimin në kohë, do të duhet të kishin qenë të konsiderueshme dhe të qenësishme për të superuar zhvlerësimin që passjell përdorimi shtatëvjeçar. Subjekti nuk ka deklaruar shpenzime/investime të kryera mbi automjetin, në deklaratimet periodike të vitit 2012 [kur ka lindur detyrimi për shpenzimet e deklarueshme] deri në vitin 2015/viti i shitjes, dhe po ashtu, nuk vërtetoi me dokumentacion mbështetës, qoftë edhe rrethanor, natyrën e spikatur apo konkretizuar

---

<sup>29</sup> *Data e blerjes së automjetit.*

ekspertizën e specializuar automekanike, që mundëson krijimin e përfitimeve të konsiderueshme për automjetet që përdor ai, në më shumë se një rast.

13.17. Për këto arsye dhe nën dritën e garancive procedurale me ankimin, në analizën e kryer në Kolegj, u pranuan vlerat financiare që ka përfshirë Komisioni, në kushte tejet favorizuese për subjektin. Konkretisht, Komisioni, edhe për këtë zë të analizës financiare, ka përfshirë burime të padeklaruara<sup>30</sup> nga subjekti, qoftë në deklaratën periodike për vitin 2008 apo edhe gjatë hetimit administrativ – siç janë të ardhurat e prindërve [nga pensionet dhe fitimi neto i personit fizik të nënës së tij]. Sikurse edhe për automjetin tjetër, Kolegji vëren se arsyetimi mbi të cilin Komisioni kushtëzon të ardhurat e përfshira në analizë me pagesën e tatimeve, është i pabazuar. Pretendimi i subjektit se fitimi nga shitja e automjeteve, nuk tatóhet në rrethanat e tij, vlerësohet i drejtë, nën të njëjtën linjë arsyetimi me atë të shtjelluar më lart në lidhje me automjetin tjetër. Për rrjedhojë, edhe në Kolegj, në analizën financiare të vitit 2015, u pasqyrua si e ardhur e ligjshme nga shitja e automjetit të dytë [me targë {\*\*\*}], në datën 09.06.2015, vetëm vlera e investimit fillestar, prej 832.251 lekësh, që përfshin çmimin e blerjes dhe pagesën e zhdoganimit.

*I. C. Shuma 1.000.000 lekë, nga shitja e mjetit BMW, me targa {\*\*\*}*

13.18. Burimi tjetër i referuar në deklaratën *vetting* është edhe shuma 1.000.000 lekë, e përfituar nga shitja e mjetit “BMW”. Referuar deklaratës doganore të datës 27.10.2011, blerësi origjinal ka deklaruar si vlerë automjeti shumën 10.000 euro dhe ka paguar vlerën e zhdoganimit në shumën 347.809 lekë. Pas katër vitesh, me anë të kontratës noteriale<sup>31</sup> datë 09.06.2015, shitësi ia ka shitur këtë automjet subjektit të rivlerësimit, kundrejt çmimit *500.000 lekë*. Katër (4) muaj pas blerjes, me kontratën e datës 20.10.2015, subjekti ia ka shitur automjetin një tjetër individ [A. B.], kundrejt çmimit një milion lekë ose dyfishin e çmimit të blerjes nga vetë subjekti. Edhe ky transaksion është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Këto veprime janë deklaruar edhe në deklaratën periodike për vitin 2015 dhe referuar edhe në kontratën noteriale të shitjes nga subjekti,<sup>32</sup> datë 20.10.2015. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar *kursimet*.

13.19. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare vetëm vlerën e blerjes së automjetit dhe, në linjë me qëndrimin për automjetet e tjera, ka përjashtuar fitimin prej 500.000 lekësh, 100% nga shitja, pas katër muajsh dhe referuar dyshime për veprime fiktive dhe mospagimin e detyrimit tatimor për fitimin nga shitja e këtij automjeti.

13.20. Në ankim, subjekti potencon me të njëjtat pretendime të ngritura gjatë hetimit administrativ<sup>33</sup> dhe në propësimet kundër rezultateve të hetimit sikurse edhe për dy automjetet e tjera. Subjekti pretendon se në momentin e blerjes, automjeti nuk ka qenë në gjendje të rregullt teknike dhe ka pasur probleme me sistemin e transmetimit. Subjekti kreu disa shërbime, në vlerën

---

<sup>30</sup> Në DIPP-në 2008, subjekti nuk ka deklaruar burime, ndërsa në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 ka cituar si burim vetëm kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

<sup>31</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.06.2015.

<sup>32</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.10.2015.

<sup>33</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

283.200 lekë, të provuara me faturë,<sup>34</sup> të cilat i rritën vlerën automjetit. Komisioni është kontradiktor, potencon subjekti, në kushtet që ka përfshirë në analizën financiare vlerën 283.200 lekë të shpenzuar, ndërsa ka konsideruar si të ardhur vetëm vlerën 500.000 lekë, të përcaktuar në kontratën e blerjes nga vetë subjekti. Subjekti i kërkon Kolegjit të njohë si të ardhur të ligjshme vlerën e plotë të përfituar nga shitja e këtij automjeti ose minimalisht të përfshihet shumatorja e çmimit të blerjes 500.000 lekë dhe e investimit, prej 283.200 lekësh.

**13.21.** Në linjë me analizën për dy automjetet e tjera, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni përfundimtar i Komisionit për mospërfshirjen në analizë të fitimit të pretenduar nga shitja e automjetit, pasi subjekti e përdori atë, është i bazuar, pavarësisht nga aspektet që lidhen e kushtëzohen me mospagimin e tatimit. Ky konkluzion, sikurse shtjelluar edhe më sipër, bazohet në faktin që pretendimi për gjendjen jo të mirë teknike të mjetit në momentin e blerjes, nuk gjen mbështetje në kontratën e shitblerjes së datës 09.06.2015, e cila nuk ka asnjë referencë apo rezervë të blerësit/subjektit për defekte dhe të meta. E kundërta rezulton në kontratë, pasi subjekti/blerësi ka deklaruar se është siguruar për gjendjen teknike të mjetit. Po kështu, pretendimi për kryerjen e investimit, me vlerë 283.200 lekë, nuk gjen mbështetje në faturën e shitjes, të sjellë si provë.

**13.22.** Edhe duke abstraguuar nga mungesa e besueshmërisë dhe e vlerës provuese të këtij akti, nën dritën e kërkesave për të bazuar vendimin në akte që janë në harmoni me provat dhe nga burime të besueshme, sipas pikës 4, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, fatura e thjeshtë e shitjes nuk konfirmon pretendimin. Zërat e shërbimeve të përshkruara në të janë kryesisht shërbime “rutinë” të mirëmbajtjes tipike vjetore të një automjeti. Asnjë prej tyre nuk paraqitet si riparim themelor apo i natyrës funksionale, që të mund të rriste vlerën e kësaj pasurie në mënyrë të konsiderueshme. Ky shpenzim i faturuar në datën 15.09.2015, nuk ka lënë gjurmë as në deklaratën për vitin 2015, në të cilën subjekti ka deklaruar vetëm shpenzimin e vlerës 500.000 lekë, për blerjen e automjetit, dhe jo shumë 283.500 lekë të shpenzimeve të pretenduara se janë kryer në këtë vit, që gjithsesi kanë rritur vlerën e automjetit përtej shpenzimeve neto të kryera nga subjekti. Deklarimi i shpenzimeve do të shërbente si indicie në drejtim të besueshmërisë së shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit.

**13.23.** Së fundmi, trupi gjykues sjell në vëmendje edhe jurisprudencën e Kolegjit, se fiktiviteti i çmimeve mund të jetë në të dyja kahet, atë të shitjes, por edhe atë të blerjes. Në këtë rast, çmimi fiktiv mund të ketë konsistuar edhe në uljen e vlerës në momentin e blerjes. Kështu, sipas deklaratës doganore, datë 27.10.2011, të shitësit fillestar, vlera e automjetit është 10.000 euro dhe vlera e zhdoganimit është në shumë 347.809 lekë. Referuar kursit të këmbimit të kohës, prej 140.95 lekësh, të specifikuar në deklaratën doganore, vlera prej 10.000 eurosh e automjetit, së bashku me shpenzimet doganore, do të ishte shumatorja e 1.409.500 lekë dhe 347.809 lekë, ose *1.757.309 lekë*. Nisur nga kjo vlerë e konsiderueshme, duke mbajtur në konsideratë edhe amortizimin për 4 vjet të një automjeti asokohe relativisht të ri [prodhuar në vitin 2006 dhe shitur

---

<sup>34</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar një faturë shitjeje, datë 15.09.2015, në shumë totale 283.200 lekë, lëshuar nga z. E. L., në datën 15.09.2015, për riparime të automjetit “BMW”, sipas zërave: kambio, vaj kambio, filtër vaj kambio, vaj motori, filtër vaj motori, filtër ajri, filtër naftë, filtër kabine, diferencial, gomat e përparme dhe të pasme, si dhe punëtorja.

në vitin 2011], çmimi i shitjes të subjekti i rivlerësimit, prej 500.000 lekësh ose afërsisht 3.5 herë më pak, nuk duket bindës. Këtë bindje e përforcon edhe më shumë fakti që subjekti, vetëm 4 muaj pas blerjes, deklaroi se e shet automjetin në një vlerë 1.000.000 lekë. Parë edhe në këtë këndvështrim, pretendimet e subjektit nuk rezultojnë të besueshme për trupin gjykues.

**13.24.** Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, për burimet e ligjshme për blerjen e automjetit tip “BMW” në vitin 2015, kundrejt vlerës 500.000 lekë, sipas kontratës, dhe për kryerjen e investimeve të tjera, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një balancë pozitive prej 311.700 lekësh. Në këtë analizë është pasqyruar si shpenzim edhe vlera 283.200 lekë, meqenëse pranohet nga vetë subjekti si një shpenzim faktik i kryer. Pretendimi për mungesë detyrimi tatimor për fitimin, konfirmohet edhe në këtë rast.

**13.25.** Në vijim të arsytimit të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar kërkimin e subjektit për të përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme që ai dispononte, në funksion të pasurisë objekt analize, një vlerë/të ardhura që përfshijnë edhe vlerën e investimit -- në total në shumën 783.200 lekë [500.000 lekë çmimi i blerjes dhe 283.200 lekë investimi i kryer]. Në analizën financiare të vitit 2015, nga shitja e automjetit “BMW”, në linjë me Komisionin, edhe në Kolegj u përfshi vetëm vlera 500.000 lekë, e përcaktuar në kontratë. Pjesa tjetër e të ardhurave, qofshin ato si pretendim i bazuar në investimet e kryera apo nga shitja në dyfishin e vlerës së blerjes së automjetit, nuk u përfshinë në mesin e të ardhurave të ligjshme në vijim të konstatimit për çmime fiktive. Duke ritheksuar se argumentimi i Komisionit për mospërfshirjen për shkak të tatimit mbi fitimin e gjeneruar, është i gabuar, aspekti i veprimeve pa logjikë ekonomike qëndron.

**13.26.** Edhe në versionin më favorizues për subjektin -- nëse për automjetin “BMW” do të përfshihej si e ardhur e gjithë vlera 783.200 lekë -- rezultati financiar i vitit 2015 do të mbetej sërish negativ. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të nënvizojë qasjen favorizuese të Komisionit, edhe në këtë aspekt të analizës, në formën e përfshirjes së burimeve të padeklaruara financiare nga subjekti. Konkretisht, ndonëse subjekti ka cituar *kursimet* si burim për blerjen e këtij mjeti, në deklaratën për vitin 2015, Komisioni ka zgjedhur të përfshijë si burime edhe shitjen e automjetit tjetër, meqenëse ka ndodhur në të njëjtën datë – në 09.06.2015, automjeti i dytë, me targa {\*\*\*}, analizuar më sipër. Kjo qasje është e pakuptimtë dhe alogjike në kushtet që të ardhurat nga shitja e atij automjeti kanë shërbyer, janë deklaruar dhe përfshirë në mesin e burimeve financiare për efekt të automjetit të katërt. Ky konstatim parashtrohet për të nënvizuar të kundërtën e pretendimit për qëndrim paragjykues dhe të njëanshëm ndaj subjektit nga Komisioni. Nga ana tjetër, panorama faktike e pretenduar prej tij konfirmon nevojën e subjektit për të krijuar, nëpërmjet transaksioneve zinxhir, përshtypjen e burimeve financiare të mjaftueshme për t’i shërbyer nevojave për investim, në vitin 2015.

*I. D. Pretendimet lidhur me burimin e katërt, kursime dhe analizën financiare të automjetit të deklaruar në deklaratën vetting, “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}*

**13.27.** Komisioni kreu analizën financiare paraprahe të automjetit “Mercedes-Benz” objekt kontrolli, në të cilën ka përfshirë: (i) vlerat e tri automjeteve të mësipërme, sipas çmimeve të blerjes në kontrata; (ii) të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe nga aktiviteti tregtar si person

fizik i bashkëshortes së tij, për harkun kohor janar 2015 – 18.11.2015<sup>35</sup>; dhe (iii) nuk ka përfshirë likuiditetet *cash*, me argumentin se nuk ka gjurmë deklarimi të tyre, në deklaratën periodike për vitin 2015. Në bazë të kësaj analize paraprake, subjekti rivlerësimi rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën (-) 2.047.318 lekë, për blerjen e automjetit. Ky rezultat, i cili iu njoftua subjektit me rezultatet e hetimit, krahas gjetjeve të tjera për fiktivitet të çmimeve dhe mospagimit të detyrimeve tatimore nga shitja e tyre, është analizuar në paragrafët e mësipërm.

**13.28.** Në kuadër të barrës së provës, subjekti kundërshtoi rezultatin e analizës financiare të automjetit objekti vlerësimi, duke pretenduar, përpos si për automjetet e tjera, edhe që fitimi nga aktiviteti i bashkëshortes si person fizik nuk duhet përllogaritur në mënyrë përpjesëtimore në raport me të ardhurat e vitit, pasi nuk mund të përcaktohet se sa kanë qenë të gjithë zërat e një bilanci në një datë të caktuar, që e bën të pamundur përllogaritjen e saktë të fitimit. Subjekti nuk ka pretenduar ndonjë vlerë konkrete të fitimit për periudhën e analizuar. Po ashtu, subjekti ka kërkuar që në mesin e burimeve financiare të disponuara për këtë automjet të përfshihen kursime *cash* ndër vite, në shumën 900.000 lekë, që sipas tij janë deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2015. Subjekti ka paraqitur një analizë financiare për blerjen e automjetit, në të cilën ka zvogëluar/pakësuar gjendjen *cash* me 900.000 lekë, ndërsa në rubrikën e të ardhurave ka shtuar shumat e shpenzuara për riparimet e automjeteve, duke rezultuar me një balancë pozitive.

**13.29.** Përpos sa referuar më sipër, për mungesë të logjikës ekonomike të veprimeve të analizuara në blerjen lirë dhe shitjen shtrenjtë për të tri automjetet, bazuar në qëndrimin orientues të Kolegjit,<sup>36</sup> Komisioni ka vlerësuar të mos pranojë pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizë vlerën 900.000 lekë nga *cash*-i, duke theksuar se subjekti nuk e ka deklaruar në vitin përkatës pakësimin e gjendjes së disponuar *cash* në banesë. Nga ana tjetër, Komisioni ka pranuar pretendimin mbi përdorimin e *mundshëm* të kursimeve të disponuara *cash* në banesë gjatë vitit 2015, për blerjen e automjetit dhe mundësinë financiare për t'i rikrijuar/zëvendësuar ato deri në fund të vitit, ndonëse përdorimi i tyre *nuk* është deklaruar as në deklaratën periodike për vitin 2015 dhe as në deklaratën *vetting*, si një ndër burimet për blerjen e kësaj pasurie. Si pasojë e kësaj qasjeje të re, Komisionit i rezultoi se, deri në fund të vitit 2014, subjekti ka pasur kursime në masën 3.666.000 lekë, të cilat duke u shtuar si një ndër burimet, do të ishin të mjaftueshme për të mundësuar blerjen e automjetit në fjalë. Por, subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej (-) 834.039 lekësh, për të riplotësuar kursimet *cash*, deri në fund të vitit 2015, rezultat i cili, në vetvete, sipas Komisionit, nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

**13.30.** Në ankim, subjekti vijon të potencojë të njëjtat pretendime me ato të ngritura më herët gjatë hetimit administrativ dhe pas kalimit të barrës së provës në lidhje me tri automjetet që kanë

---

<sup>35</sup> Sipas Komisionit, nga dokumentacioni i përcjellë nga DRT-ja Fier ka rezultuar se personi fizik A. S. rezulton të jetë regjistruar në DRT Fier me aktivitet privat: përmbarues gjyqësor deri në datën 29.07.2013 dhe pas kësaj date, "noter". Personi fizik ka realizuar të ardhura si vijon: (i) në vitin 2012, fitimi pas tatimit 2.104.864 lekë; (ii) në vitin 2013, fitimi pas tatimit 2.332.834 lekë; (iii) në vitin 2014, fitimi pas tatimit 2.025.737 lekë; (iv) në vitin 2015, fitimi pas tatimit 2.918.714 lekë; dhe (v) në vitin 2016, fitimi pas tatimit 2.649.239 lekë. Personi fizik në emër të bashkëshortes së subjektit nuk ka pasur detyrim ligjor për shpërndarje dividendi.

<sup>36</sup> Vendimi nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit E. S.

shërbyer si burim. Konkretisht, ai pretendon se, pavarësisht se nuk ka deklaruar kursimet dhe ndryshimin e likuiditeteve gjendje *cash*, në deklaratën periodike për vitin 2015, i ka pakësuar ato me 900.000 lekë, duke argumentuar se deklarimi i blerjes së automjeteve prezumon edhe pakësimin e likuiditeteve *cash* dhe e kundërta, shitja e automjeteve prezumon shtimin e gjendjes *cash*. Në linjë me prapësimet kundër rezultateve të hetimit, subjekti pretendon [ndonëse jo saktësisht në këtë shkak ankimi], edhe që për vitin 2015, fitimi neto nga aktiviteti i personit fizik A. S. ka qenë më i lartë se ai i përlllogaritur nga Komisioni, i cili e ka përlllogaritur në mënyrë përpjesëtimore fitimin për periudhën janar 2015 – 18.11.2015. Në përfundim, subjekti potencon se në versionin e analizës financiare, të hartuar nga eksperti i pajtuar prej tij, konfirmohet jo vetëm mundësia financiare e subjektit me burime të ligjshme, për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, në datën 18.11.2015 [konkluzion edhe i Komisionit], por balanca e vitit 2015 mbyllet me rezultat pozitiv, që do të thotë se ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, subjekti ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme, për të rikrijuar gjendjen *cash*, deri në fund të vitit 2015.

13.31. Pretendimet e mësipërme u vlerësuan të pabazuara. Ky vlerësim është rrjedhojë e situatës faktike e ligjore, që rezultoi nga shqyrtimi i tyre në raport me aktet në dosjen e Komisionit, sipas argumentimit të shtjelluar në vijim. Në parantezë, trupi gjykues i Kolegjit çmon të nënvizojë faktin që *kursimet* janë deklaruar si burim për blerjen e automjetit objekt vlerësimi vetëm në deklaratën periodike për vitin 2015. Në deklaratën *vetting*, në pyetësorët nr. 1 dhe nr. 2, por edhe në ankim, ato nuk deklarohen si burime. Mospërputhjet e theksuara në deklarime, jo vetëm që nuk janë bërë pjesë e analizës dhe e gjetjeve gjatë hetimit në asnjë fazë të vlerësimit të kësaj pasurie gjatë hetimit administrativ, por mbi të gjitha, krahas tri burimeve nga shitja e automjeteve të deklaruara në deklaratën *vetting*, Komisioni ka përfshirë në mesin e burimeve të disponuara e përdorura edhe kursimet sipas deklaratës periodike të vitit 2015. Kjo zgjedhje është kontradiktore, në kushtet që vetë Komisioni ka konstatuar se përdorimi i tyre nuk është deklaruar konkretisht në deklaratën periodike përkatëse si një ndër burimet për blerjen e kësaj pasurie. Së fundmi, Komisioni ka përfshirë edhe të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe nga aktiviteti i bashkëshortes së tij si person fizik. Edhe këto dy aspekte potencohen si shembuj, që rrëzojnë pretendimet e subjektit, se Komisioni është treguar paragjykues për të.

13.32. Pretendimi i subjektit për mënyrën se si deklarata e tij periodike duhet të lexohet për të interpretuar pakësimin e gjendjes *cash*, në vlerën 900.000 lekë, në vitin 2015, është i pambështetur në ligj, në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, dhe alogjik nën dritën e akteve dhe deklarimeve të tij. Së pari, formulari dhe ligji nr. 9049/2003, pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar, ka kërkuar në mënyrë konsistente dhe specifike të deklarohen likuiditetet e kursyera dhe *shtesa* apo *pakësimi* i tyre. Kjo premisë paraqet rëndësi të veçantë në rastin e kursimeve jashtë sistemit bankar, për të cilat saktësia e deklarimit në deklaratën periodike është me rëndësi kyçe për efekt të ligjit. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, subjekti ka deklaruar se e ka financuar blerjen e automjetit objekt vlerësimi me kursime, që nënkupton prezumimin ligjor të pakësimit të kursimeve të disponuara dhe të deklaruara. Nga ana tjetër, të ardhurat e fituara nga shitja e mjetit, nëse nuk deklarohen të ruajtura si kursime dhe si shtesë e këtyre të fundit, nuk mund të prezumohen të përdorura për këtë qëllim. Edhe deklarimi në deklaratën *vetting* i subjektit është në linjë me këtë

kuptim të saktë të ligjit – për sa kohë ai ka konkretizuar si burim shitjen e automjeteve të tjera dhe jo të njëjtat burime si në deklaratën periodike.

13.33. Sikurse elaboruar edhe në vendime të mëparshme të Kolegjit, ligji nr. 9049/2003 përcakton për subjektet deklaruese detyrimin ligjor për të deklaruar saktësisht ndryshimet e pasurisë, përfshirë edhe ndryshimet e likuiditeteve *cash*. Po ashtu, sipas qëndrimit orientues<sup>37</sup> të Kolegjit, sa më sipër nënkupton që nuk duhet të prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë *nuk* është deklaruar në mënyrë të qartë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike dhe atë *vetting*. Sikurse sqaruar edhe më lart, në deklaratën *vetting*, në pyetësorë dhe në pikën 86 të ankimit, subjekti ka konfirmuar vetëm tre (3) burime për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz” (objekt vlerësimi) -- të ardhurat nga shitja e automjeteve që kishte në pronësi më herët dhe jo kursimet. Këto deklarime e përjashtojnë pretendimin e subjektit për pakësimin e gjendjes *cash* në funksion të blerjes së automjetit objekt shqyrtimi. Së fundmi dhe si *obiter dictum*, edhe shitja me fitime formalisht të konsiderueshme e tri automjeteve, brenda të njëjtit vit, nga subjekti, përforcon bindjen për mungesën e likuiditeteve nga kursimet dhe fiktivitetin e çmimeve. Nëse subjekti kishte këto fonde kursimesh në dispozicion, do të ishte e pritshme që deklarata *vetting* – rreth një vit pas blerjes së automjetit objekt analize – do të fokusonte/fotografonte pikërisht këtë gjendje kursimesh të disponuara.

13.34. I pabazuar rezultoi edhe pretendimi për përlllogaritjen në mënyrë jopërpjesëtimore të fitimit të personit fizik në emër të bashkëshortes. Në analizën financiare të hartuar për vitin 2015, Komisioni ka përfshirë fitimin nga të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti, bazuar në përgjigjet e subjektit në pyetësorë, në dokumentacionin bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorëve, si edhe në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ky dokument përcakton qarkullimin, shpenzimet dhe fitimin e realizuar pas tatimit, në vlerën 2.918.714 lekë, për të gjithë vitin financiar, jo në nivelin mujor. Për më tepër, as subjekti i rivlerësimit nuk ka pretenduar ndonjë vlerë konkrete të fitimit për periudhën e analizuar dhe as ka depozituar dokument, që të vërtetojë një mënyrë ndryshe, jopërpjesëtimore të shpërndarjes të të ardhurave, shpenzimeve dhe fitimit. Subjekti është përballur me këtë mungesë konkretizimi edhe në seancë dëgjimore, vënë në dukje nga relatori i çështjes. Për rrjedhojë -- sipas relatorit në Komision -- ka qenë detyrim i subjektit, nëpërmjet ekspertit të tij kontabël, i cili kishte akses në të gjitha librat e biznesit të bashkëshortes, të kundërshtonte mënyrën e llogaritjes nga Komisioni, me ndonjë alternativë përlllogaritjeje. Për këtë arsye, në kushtet që subjekti nuk ka provuar një mënyrë të ndryshme përlllogaritjeje nga ajo përpjesëtimore, të kryer nga Komisioni, përfshirë edhe në ankim, trupi gjykues i Kolegjit u bazua në një përlllogaritje shpërndarjeje përpjesëtimore të fitimit të personit fizik, për vitin 2015. Akti i ekspertizës bashkëlidhur ankimit, përveçse nuk plotëson kërkesat e provave të reja të parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, nuk shërben për vitin 2015, pasi është hartuar specifikisht për vitin financiar 2016.

---

<sup>37</sup> Vendimi nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, paragrafi 39, që i përket subjektit E. S.

13.35. Në linjë dhe në përmbledhje të premisave të mësipërme, në analizën e kryer në Kolegj për financimin e automjetit, në tetor 2015, u kryen korrigjimet përkatëse për sa arsyetuar më sipër në lidhje me pretendimet e potencuara në këtë shkak ankimi, ndërsa u mbajtën në konsideratë garancitë procedurale të subjektit për ato çështje, për të cilat Kolegji konstatoi qasje favorizuese nga ana e Komisionit. Nga ky kontroll financiar në Kolegj rezultoi se subjekti i rivlerësimit *nuk* ka pasur mundësi me burime financiare të ligjshme, gjatë vitit 2015, që të mbulonte shpenzimet e kryera gjatë vitit, si edhe të riplotësonte kursimet *cash*, deri në fund të këtij viti. Në Kolegj u konfirmua balanca negative në vlerën (-) 834.039 lekë, e konstatuar në Komision.

13.36. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë edhe faktin që Komisioni në vendim, duket të mos ketë dhënë qëndrim lidhur me balancën negative prej rreth 2 milionë lekësh, për krijimin e automjetit në vitin 2015, sipas rezultateve të hetimit, duke zgjedhur të pranojë pretendimet gjatë procesit të hetimit administrativ, për përdorim e zëvendësim të likuiditeteve *cash*, në kundërshtim me qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit, në kushtet që këto burime nuk identifikohen në deklaratat periodike apo në atë *vetting*.

13.37. Në përmbledhje të sa më sipër, në kushtet që balanca negative e vitit 2015 u konfirmua edhe në analizën e kryer në Kolegj, ky konkluzion i vendimit objekt ankimi u gjet i bazuar. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga pikat 1 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe germa “b” e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion bazohet në problematikat që u evidentuan qoftë për burimet e krijimit të automjetit, pakësimit të kursimeve dhe zëvendësimit të tyre në fund të vitit 2015, por edhe të mungesës së besueshmërisë së shpjegimeve të subjektit, shtjelluar më sipër.

## *II. Apartament banimi në qytetin e Vlorës, në pronësi të bashkëshortes së subjektit*

14. Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka deklaruar pronësinë e saj individuale [në pjesën 100%] mbi apartamentin e banimit me sipërfaqe 49 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, në Vlorë, me vlerë 2.800.000 lekë, sipas kontratës së porosisë, datë 02.09.2005. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat personale nga puna dhe nga ato të krijuara nga prindërit e saj në emigracion. Komisioni ka konkluduar se prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej (-) 2.678.889 lekësh, për blerjen e këtij apartamenti. Po ashtu, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk provoi se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive, të parashikuara në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit,<sup>38</sup> Komisioni nuk e ka konsideruar proporcional penalizimin e subjektit për shkak të kësaj pasurie, por situata financiare në lidhje me të do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor në lidhje me kriterin e pasurisë. Komisioni mbajti në konsideratë që: (i) kontrata e porosisë është nënshkruar në vitin 2005 dhe pagesat ndaj palës shitëse janë kryer prej bashkëshortes, përpara martesë; (ii) ka ekzistuar së paku një deklaratë noteriale e kohës, e vitit 2010, përpara procesit të rivlerësimit, në të cilën babai i bashkëshortes së subjektit ka deklaruar se

---

<sup>38</sup> Komisioni ka cituar vendimin e Kolegjit nr. 19, datë 10.06.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit A. G.

apartamenti i është dhuruar vajzës së tyre, përpara martesës; (iii) nuk ka rezultuar ndonjë kontribut financiar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie.

14.1. Në ankim, përpos rikonfirmimit të shpjegimeve të dhëna gjatë dhe në mbyllje të hetimit administrativ, subjekti ka potencuar sa përmbledhur më sipër, në hyrje të këtij vendimi, me fokus se prindërit e bashkëshortes kanë të ardhura të ligjshme të mjaftueshme dhe që ai është në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion provues për të ardhurat përpara vitit 2002. Subjekti, po ashtu, ka potencuar se barra e provës për të ardhurat e prindërve të bashkëshortes përpara martesës së tij është e paarsyeshme. Nëse do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare, do të afektonte një pasuri që nuk është e subjektit, por e bashkëshortes, përpara lidhjes së martesës. Subjekti argumenton se mënyra se si e ka analizuar Komisioni këtë pasuri është në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, në shkelje të rëndë të parimit të sigurisë juridike dhe mosdënimit pa faj, sanksionuar në nenin 7 të KEDNj-së.

14.2. Trupi gjykues vëren se edhe në Kolegj u konfirmua një balancë negative e konsiderueshme për krijimin e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, konstatimi i Komisionit u konfirmua edhe pas disa korrektiveve të analizës financiare të kryer në Kolegj. Për qëllime saktësi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se arsyetimi i Komisionit është kontradiktor, në kushtet që, ndërsa fillimisht konkludon [në paragrafin 59] se një mungesë burimesh thuhet se gjithë vlera e apartamentit, nuk do t'i ngarkohet subjektit si pasojë në proces, nën dritën e proporcionalitetit, ndërsa më tej [në paragrafin 109] referohet se kjo balancë negative do të jetë pjesë e vlerësimit *tërësor të pasurisë*. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se, ndonëse me mangësi, është i bazuar vlerësimi i Komisionit për mbajtjen në konsideratë të rezultuar nga kontrolli i kësaj pasurie, në kontrollin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të/bashkëshorten. Në kontekstin e besueshmërisë së subjektit në kontrollin e kriterit të pasurisë, duke mbajtur në konsideratë garancitë procedurale të subjektit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit i bëri pjesë të analizës së tij edhe problematikat që rezultuan, përfshirë pamundësinë e krijimit të kësaj pasurie nga dhuruesit, apo edhe kundërthëniet e paqartësitë në deklaratimet e kryera për të, nga subjekti dhe personi i lidhur. Ky vlerësim u bazua në situatën faktike dhe ligjore që rezultoi në Kolegj gjatë shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, shtjelluar në vijim të këtij vendimi.

14.3. Për herë të parë, ky apartament është deklaruar në deklaratat periodike për vitin 2008 [të dorëzuara respektivisht nga subjekti dhe nga bashkëshortja, secili në cilësinë e subjektit deklarues për shkak të funksionit]. Në këto akte, apartamenti përshkruhet me vlerë 3.100.000 lekë dhe si *dhurim* nga prindërit e bashkëshortes. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës *vetting* dhe atij të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se ky apartament është porositur kundrejt çmimit 2.800.000 lekë, me anë të kontratës *jonoteriale* të porosisë, datë 02.09.2005, të lidhur ndërmjet bashkëshortes së subjektit [znj. A. L.] dhe dy shoqërive ndërtuese.<sup>39</sup> Në datën 12.02.2007, të njëjtat palë kanë nënshkruar edhe kontratën *noteriale*<sup>40</sup> të shitblerjes të pasurisë kundrejt çmimit 2.857.500 lekë. Në datën 21.02.2007, kjo pasuri është regjistruar në pronësi individuale të blerëses. Në deklaratat periodike për vitet 2005 – 2007, nuk janë deklaruar kontrata

<sup>39</sup> “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK.

<sup>40</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.02.2007.

e porosisë dhe ajo e shitblerjes e vitit 2007, as nga subjekti dhe as bashkëshortja e tij, e cila në këto vite ka qenë subjekt deklarues për shkak të funksionit.

14.4. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i këtyre kontratave ishte për shkak se ai dhe bashkëshortja nuk njiheshin në ato vite. Ata kanë lidhur martesë në datën 28.09.2007, pas kontratës së shitjes. Sa i përket mospërputhjes së konstatuar ndërmjet vlerës së kësaj pasurie, prej 3.100.000 lekësh, me vlerat 2.800.000 lekë apo 2.857.500 lekë, të përcaktuara në kontratën e porosisë dhe kontratën e shitjes, subjekti ka shpjeguar se çmimi i blerjes është 2.800.000 lekë, sipas kontratës së porosisë, dhe do të paguhej me dy këste: shuma 1.160.000 lekë, në datën 02.09.2005, kur është lidhur kontrata e porosisë, dhe shuma 1.640.000 lekë, në datën 25.12.2005. Ky çmim konfirmohet edhe nga mandatpagesat e depozituara bashkëlidhur këtyre përgjigjeve.<sup>41</sup> Subjekti u shpreh se, përveç çmimit, bashkëshortja e tij ka kryer edhe pagesat për regjistrimin e kësaj pasurie në vlerat 105.000 lekë dhe 160.000 lekë,<sup>42</sup> të cilat e kanë çuar vlerën totale të shpenzuar në 3.100.000 lekë. Ndërsa mospërputhjet e burimeve<sup>43</sup> të krijimit të pasurisë mes deklaratës *vetting* dhe deklaratës periodike, për vitin 2008, janë lapsus, sipas tij dhe fondet për blerjen e këtij apartamenti janë dhënë *tërësisht* prej prindërve të bashkëshortes.

14.5. Për të vërtetuar dhurimin e prindërve të bashkëshortes, subjekti ka depozituar<sup>44</sup> edhe një deklaratë noteriale të kohës,<sup>45</sup> datë 01.04.2010, të babait të bashkëshortes, i cili deklaroi se pagesa e këtij apartamenti është përballuar prej tij dhe bashkëshortes, si një dhuratë për vajzën e tyre, para martesës së saj. Sipas kërkesës së Komisionit, për të përjashtuar dyshimet për ndonjë kontribut financiar të mundshëm të subjektit të rivlerësimit në këtë investim, subjekti ka paraqitur<sup>46</sup> dy mandatpagesat e likuidimit të çmimit të shitblerjes nga bashkëshortja, konkretisht pagesën e shumës prej 1.160.000 lekësh, në datën 02.09.2005, dhe të shumës 1.640.000 lekë, në datën 20.12.2005, duke shpjeguar se bashkëshortja e tij ka jetuar në këtë apartament në periudhën shkurt 2005 – 2007 dhe që përdoret nga familja e tij për pushime e nuk është dhënë asnjëherë në përdorim apo me qira. Si dëshmi për vërtetësinë e pagesave, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka vënë në dispozicion edhe deklaratën noteriale të bashkëshortes dhe përfaqësuesit të njërit prej shoqërive ndërtuese,<sup>47</sup> hartuar në datën 03.07.2021. Në këtë akt janë konfirmuar deklaratimet e bashkëshortes së subjektit për lidhjet e kontratave të viteve 2005 dhe 2007, dhe çmimet e rëna dakord.

14.6. Për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 3.100.000 lekë, dhuruar bashkëshortes nga prindërit e saj, subjekti shpjegoi se këto fonde janë krijuar me të ardhurat e tyre nga emigracioni në Greqi, prej vitit 1991. Bashkëlidhur këtyre përgjigjeve, subjekti ka paraqitur një deklaratë

---

<sup>41</sup> Bashkëlidhur me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti ka depozituar mandatin datë 02.09.2005, në shumën 1.160.000 lekë dhe mandatin datë 20.12.2005, në shumën 1.640.000 lekë.

<sup>42</sup> Bashkëlidhur deklaratës *vetting* janë depozituar mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, datë 15.10.2006, me vlerë 105.000 lekë, dhe mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, datë 15.09.2006, në shumën 160.000 lekë.

<sup>43</sup> Në deklaratën *vetting*, si burim të kësaj pasurie janë deklaruar: (i) të ardhurat e saj nga puna dhe (ii) nga prindërit në emigracion, ndërsa në DIPP-në 2008 është deklaruar si burim vetëm dhurimi nga prindërit e bashkëshortes.

<sup>44</sup> Me përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

<sup>45</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.04.2010.

<sup>46</sup> Me përgjigjet e pyetësorit nr. 4.

<sup>47</sup> Z. Gj. B., i cili ka nënshkruar kontratën e porosisë, datë 02.09.2005, në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë ndërtuese "{\*\*\*}" ShPK.

noteriale datë 23.11.2020, të lëshuar nga nëna dhe vëllai i bashkëshortes, në Greqi, në të cilën kanë deklaruar se këstet për likuidimin e vlerës monetare për apartamentin në Vlorë i kanë paguar ata, pasi kanë punuar në Greqi, pa ndërprerje.

14.7. Në mbështetje të pretendimit për mundësitë financiare të familjes së bashkëshortes për të financuar pagesat për apartamentin objekt vlerësimi, subjekti depozitoi dokumentacion të përkthyer në gjuhën shqipe nga greqishtja, që sipas tij provon të ardhurat e prindërve nga viti 2002, si viti i parë i deklarimit *online*. Përpara vitit 2002 pretendoi se nuk ka të dhëna për të ardhurat, pasi aktet të cilat në atë kohë merreshin fizikisht “me pulla” dhe jo në mënyrë elektronike, nuk janë ruajtur nga prindërit e bashkëshortes. Sipas subjektit, vjehrra ka realizuar paga shumë herë më të larta nga ato të deklaruara, pasi ka punuar si “personel shtëpie” te punëdhënës të ndryshëm, duke deklaruar vetëm kontributet minimale për këtë kategori. Ndërkohë, vjehrra ka realizuar rreth 43.798 euro të ardhura gjatë kësaj periudhe, sipas vërtetimit të lëshuar. Për vitet 2004 dhe 2005 nuk është deklaruar për të gjitha ditët e punës dhe në vlerën e mësipërme nuk përfshihet bonusi i marrë nga paga. Për sa më sipër, subjekti ka kërkuar që Komisioni të vlerësojë se subjekti ndodhet në kushtet e parashikuara nga pika 2 e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka kërkuar që Komisioni të marrë në konsideratë edhe vendimin e Kolegjit që i përket subjektit A. G., sipas të cilit mungesa e burimeve të ligjshme financiare nga personat e tjerë të lidhur, për pasuri të krijuara nga bashkëshortët përpara martesë, nuk përbëjnë shkaqe për marrjen e masës disiplinore.<sup>48</sup>

14.8. Komisioni duket se ka pranuar shpjegimet e subjektit lidhur me mosdeklarimin në vitet 2005 – 2007 dhe me mospërputhjet lidhur me vlerën e apartamentit, pasi në konkluzionin përfundimtar të kësaj pasurie nuk i rendit më si gjetje. Në analizën e kryer nga Komisioni janë përfshirë si të provuara vetëm të ardhurat nga punësimet e prindërve të bashkëshortes së subjektit gjatë periudhës 2002 – 2005, në masën totale 43.798 euro [të konvertuara në 5.699.514 lekë]. Kjo vlerë rezultoi e përafërt me vlerën 5.578.402 lekë, të shpenzimeve të jetesës në Greqi, për të njëjtën periudhë, të përlllogaritur sipas të dhënave të Eurostat. Komisioni nuk e gjeti të provuar pamundësinë objektive në kuptim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin apo prindërit e bashkëshortes.

14.9. Sikurse referuar edhe më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të *pabazuar* pretendimin për barrë prove të paarsyeshme, në linjë me qëndrimet e Kolegjit në çështje ligjore të kësaj natyre.<sup>49</sup> Pavarësisht se prindërit e bashkëshortes, në rastin konkret, nuk përfshihen në rrethin e “personave të tjerë të lidhur” me subjektin e rivlerësimit, sipas një leximi harmonik të nenit 3, pikat 9 e 14 të ligjit nr. 84/2016, dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, kjo situatë nuk mund të pengojë organet e rivlerësimit të kryejnë hetime për çdo pasuri, për të cilën ka të dhëna apo dyshime të arsyeshme se mund të jetë një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, vlerësohet se Komisioni nuk ka qenë në tejkallim të kompetencave dhe as i ka ngarkuar subjektin barrë prove të paarsyeshme lidhur me mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes për blerjen e këtij apartamenti.

---

<sup>48</sup> Gjithashtu, subjekti citon si referencë edhe vendimin nr. 15/2021, të subjektit K. S.

<sup>49</sup> Vendimi nr. 15, datë 17.07.2019, paragrafi 110, për subjektin D. Rr.; vendimi nr. 21, datë 10.09.2020, paragrafët 74 dhe 75 të subjektit R. J.; vendimi nr. 36, datë 27.07.2023, paragrafi 22, i subjektit E. M. etj.

14.10. Pretendimi se subjekti dhe familjarët e bashkëshortes ndodhen në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion për të ardhurat e realizuara përpara vitit 2002, nuk është i bazuar. Trupi gjykues vëren se, në thelb, edhe sikurse deduktohet nga pretendimi i subjektit, ka ndryshuar vetëm sistemi i administrimit të të dhënave dhe mënyra e marrjes së tyre, të cilat përpara vitit 2002, duke mos qenë të digjitalizuara, merren nëpër sportele (apo me pulla, siç i quan subjekti) dhe pas vitit 2002 merren *online*, për shkak të digjitalizimit të sistemit. Në kuptim të dispozitës ligjore të referuar më sipër, subjekti nuk paraqiti ndonjë dokumentacion, që të provojë se autoritetet greke janë në pamundësi për të lëshuar dokumentet mbi të ardhurat e realizuara dhe kontributet e paguara nga familjarët e bashkëshortes përpara vitit 2002. Po kështu, subjekti dështoi të provonte se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri apo nuk mund të merret në rrugë tjetër. Sikurse do të shtjellohet në vijim, subjekti nuk paraqiti asnjë dokument që të provonte, së paku, ekzistencën e ndonjë marrëdhënieje punësimi të familjarëve të bashkëshortes dhe shumat e pretenduara si të fituara, përpara vitit 2002. Ndërkohë, nga aktet e sjella prej tij, rezulton se, më së paku, nëna dhe vëllai i bashkëshortes vijojnë të ruajnë lidhje me Greqinë – deklarata noteriale është lëshuar në Athinë, Greqi. Ky fakt, ndonëse me rëndësi dytësore, e bën më të plotë panoramën e përmbledhur më sipër, për mosqenien e tyre në pamundësi objektive për të provuar të ardhurat. Për sa më sipër, edhe ky pretendim u vlerësua i pambështetur në ligj dhe prova.

14.11. Bazuar në kërkesat kushtetuese dhe ligjore lidhur me të provuarin bindshëm dhe me dokumentacion të besueshëm, të vlerës së të ardhurave dhe ligjshmërisë së tyre, subjekti duhet të provojë të ardhurat e deklaruara dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Këto dy kërkesa ligjore duhen përmbushur në mënyrë kumulative. Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion të ardhurat në vlerat që janë pretenduar (rreth 16.000 euro në vit) e për rrjedhojë, as ligjshmërinë e tyre. Për këtë arsye, edhe pretendimi i tij, se të ardhurat e vjehrrës kanë qenë shumë më të larta se kjo vlerë, mbeti deklarativ dhe shihet si një përpjekje e pakonkretizuar, me fakte e dokumente, për të krijuar një panoramë fitimesh në përgjithësi.

14.12. Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar, ndër të tjera, vërtetimin<sup>50</sup> datë 10.06.2022, nga sistemi i Entit Kombëtar Elektronik të Sigurimeve Shoqërore të Republikës Greke. Sipas këtij vërtetimi, vjehrra e subjektit rezulton e punësuar për periudhën prill 2004 – shtator 2019. Po kështu, subjekti ka depozituar edhe një raport të printuar më datë 21.05.2022, nga sistemi “Bashkëqeverisja digjitale e sigurimeve shoqërore” ShA, me të dhënat e kontributeve të paguara nga vjehrra. Sipas këtij dokumenti evidentohen të dhëna vetëm për periudhën 01.04.2004 – 31.12.2005, gjatë së cilës janë realizuar në total të ardhura bruto në shumën 2.854,11 euro. Pretendimi se vjehrra ka deklaruar kontributet e përlllogaritura mbi pagën për kategorinë e punësimit “personel shtëpie te punëdhënës të ndryshëm”, rezulton i pambështetur në raportin e printuar, i cili nuk përmban asnjë të dhënë që kontributi që deklaroi kjo kategori të punësuarish, përlllogaritet mbi pagën minimale në shkallë vendi. Për rrjedhojë, edhe pretendimi për pagë 16.000 euro në vit ose 1333 euro në muaj, për periudhën 2004 – 2005, u vlerësua i mbetur në nivel deklarativ, sikurse edhe kërkesa që shpenzimet e jetesës të vlerësohen ndryshe nga burimet zyrtare/Eurostat, meqenëse ata kanë qenë emigrantë. Nga burime të hapura, trupi gjykues

---

<sup>50</sup> Numër protokolli {\*\*\*}.

konstaton se subjekti mund ta ketë referuar edhe këtë vlerë nga të dhënat e Eurostat për Greqinë,<sup>51</sup> për periudhën kohore në fjalë, sipas të cilave niveli mesatar i pagës ka qenë 16.000 euro.

14.13. Subjekti pretendon gjithashtu se vjehri i tij ka realizuar të ardhura gjatë kësaj periudhe, të cilat, sipas vërtetimit nr. {\*\*\*}, janë rreth 43.797,87 euro. Kjo vlerë, së pari, nuk vërtetohet të ardhura të vjehrit, por të kumatit të subjektit.<sup>52</sup> Për rrjedhojë, edhe parimisht ky dokument nuk i përgjigjet nevojës për të cilën është sjellë, në kushtet që shtesa e kumatit në mesin e personave që kontribuojnë për pasurinë është risi e fundit, gjatë hetimit administrativ, dhe nuk ka gjetur pasqyrim në asnjë akt të mëparshëm, ashtu si edhe në deklaratën *vetting* dhe atë periodike. Së dyti, edhe në nivelin konkret, kjo shumë duket e pabesueshme, pasi është shumë e përafërt me shumën bruto (44.597,87 euro), që nënkupton zbritje detyrimesh prej vetëm 800 euro për tri vite, janar 2002 – dhjetor 2005. Sa sipër, bazuar në kërkesat ligjore që burojnë nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, si edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>53</sup> lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave dhe provueshmërinë e tyre, trupi gjykues vlerëson se një pjesë e të ardhurave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nga punësimi i prindërve të bashkëshortes në Greqi, nuk e kalojnë testin e provueshmërisë, qoftë në aspektin ekzistencial apo edhe të ligjshmërisë së tyre.

14.14. Pretendimi se llogaritja e shpenzimeve të jetesës të prindërve të bashkëshortes nuk duhej bazuar në të dhënat e Eurostat, vlerësohet i pabazuar. Në kushtet që subjekti nuk ka sjellë dokumentacion provues lidhur me shpenzimet e jetesës së familjes së prindërve të bashkëshortes për vitet 2002 – 2005, e vetmja referencë për llogaritjen e tyre mbetet anketa e Eurostat. Vetë kjo anketë, në përcaktimin e shpenzimeve jetike, nuk ka bërë ndonjë kategorizim ndërmjet qytetarëve evropianë dhe atyre emigrantë. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të drejtë e të bazuar në akte konkluzionin e Komisionit, për pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të prindërve të bashkëshortes së tij, ndërsa pretendimet e potencuara nga subjekti nuk gjejnë mbështetje në akte.

14.15. Duke ndjekur rrjedhën e arsyetimit të mësipërm mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga puna e kryer në Greqi dhe për shpenzimet e jetesës, në Kolegj u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit në lidhje me mundësinë e familjarëve të bashkëshortes për financimin e plotë të këtij apartamenti. Njëjtë si në Komision, kjo analizë u shtri deri në datën 20.12.2005, në konsideratë të mandateve të dorëzuara nga subjekti për pagesën e fundit, prej 1.640.000 lekësh, për apartamentin. Ndryshe nga Komisioni, në këtë analizë financiare u përfshinë edhe të ardhurat e përfituara nga puna në periudhën 2002 – 2005, nga vjehrra e subjektit, në shumën prej 2.854 eurosh/350.809 lekësh, si edhe u saktësua vlera e shpenzimeve të jetesës, që në Kolegj rezultoi më e ulët se ajo e përlllogaritur nga Komisioni [me një diferencë prej 265.774 lekësh]. Pas korigjimit të zërave të mësipërm, balanca në Kolegj u zbut në vlerën (-) 2.062.305 lekë kundrejt vlerës (-) 2.678.888 lekë, të rezultuar në Komision. Në kushtet që edhe në Kolegj u *konfirmua pamundësia* financiare e familjarëve të bashkëshortes së subjektit, për blerjen e apartamentit në vitin 2005, trupi gjykues e

<sup>51</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/nama\\_10\\_fie\\_custom\\_20906042/default/table](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/nama_10_fie_custom_20906042/default/table)

<sup>52</sup> Këto të ardhura pretendohen në ankim si të realizuara nga vjehri, por në bazë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, ato i përkasin vëllait të bashkëshortes (V. L., i biri i L. dhe i E.).

<sup>53</sup> Vendimet: nr. 1/2021 (JR), prg. 28, për subjektin A. S.; nr. 23/2020 (JR), paragrafi 25.4., për subjektin D. P.; nr. 35/2021, paragrafi 18.6, për subjektin A. G. etj.

vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit, se prindërit e bashkëshortes kanë pasur mundësi financiare për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi.

**14.16.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se kjo pamjaftueshmëri financiare, *në vetvete, nuk* ka shërbyer si shkak për të ngarkuar me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit për këtë pasuri, por është bërë pjesë e vlerësimit tërësor të kontrollit të kriterit të pasurisë. Në pikën fundore, vlera e blerjes së këtij apartamenti nuk i është ngarkuar analizës financiare të subjektit të rivlerësimit, duke mos sjellë asnjë pasojë negative me efekt financiar për subjektin. Megjithatë, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar pretendimin e subjektit, se Komisioni nuk ka arsyetuar se përse ka vlerësuar të mbajë në konsideratë rezultatin financiar negativ të familjarëve të bashkëshortes.

**14.17.** Për qëllime saktësimi, trupi gjykues çmon të nënvizojë se është *i mangët* arsyetimi i Komisionit, në kushtet që fillimisht konkludon [në paragrafin 59] se një mungesë burimesh, thuajse sa gjithë vlera e apartamentit, *nuk* do t'i ngarkohet subjektit si pasojë, nën dritën e proporcionalitetit, ndërsa më tej [në paragrafin 109] referohet pa asnjë arsyetim, vetëm që kjo balancë negative do të jetë pjesë e vlerësimit *tërësor të pasurisë*. Trupi gjykues konstaton se, ndonëse me mangësi në arsyetim, është i bazuar vlerësimi i Komisionit për mbajtjen në konsideratë të sa rezulton nga kontrolli i kësaj pasurie në kontrollin e kriterit të pasurisë, për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të/bashkëshorten. Trupi gjykues i Kolegjit i bëri pjesë të analizës së tij edhe problematikat që rezultuan, përfshirë pamundësinë e krijimit të kësaj pasurie nga dhuruesit, apo edhe kundërthëniet e paqartësitë në deklaratimet e kryera për të, nga subjekti dhe personi i lidhur. Në këtë drejtim çmojmë të theksojmë që, edhe për këtë pasuri Komisioni ka qenë tejet favorizues për subjektin. Në analizën financiare të kryer ka përllogaritur vetëm vlerën sipas kontratës [2.8 milionë lekë] dhe jo shumën 3.1 milionë lekë, të deklaruar nga subjekti si *të shpenzuar* për këtë pasuri. Po ashtu, Komisioni ka përllogaritur të ardhurat *bruto* të prindërve të bashkëshortes, nga të cilat ka rezultuar gjithsesi një balancë negative thuajse e barabartë me atë të çmimit të blerjes.

**14.18.** Në linjë me sa më sipër, paraqet rëndësi, në mbështetje të zgjidhjes së çështjes, mungesa e besueshmërisë që rezulton në tërësi edhe për këtë pasuri, në panoramën faktike që pretendon subjekti. Konkretisht, sjellim në vëmendje që subjekti dhe bashkëshortja janë bërë me fëmijë në 3 janar 2008. Ky fakt tregon që, ndonëse martesë është lidhur në shtator 2007, subjekti dhe bashkëshortja kishin ndërthurur interesat personale më së paku duke filluar nga marsi 2007, një kohë shumë afër/thuajse e njëjtë me kohën kur është nënshkruar kontrata e shitjes së apartamentit dhe regjistrimi i tij në emër të bashkëshortes së subjektit. Edhe subjekti e ka pranuar njohjen e tyre që në vitin 2005. Këto aspekte, bashkërisht, nënkuptojnë që ndërthurja e interesave përpara martesës është tërësisht e provuar. Së dyti, fakti që personi i lidhur/bashkëshortja e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri vetëm në deklaratën për vitin 2008, pas martesë, ndonëse ajo ishte vetë subjekt deklarues dhe pretendon të ketë shlyer gjithë vlerën e apartamentit, sipas mandatpagesave që në vitin 2006, është detaj që bën kuptim vetëm nëse krijimi i kësaj pasurie përbën *më së paku* ndërthurje interesash financiarë me subjektin – në kushtet që shfaqet për herë të parë në deklaratën e tyre pas martesë. Në të kundërt, në kushtet që bashkëshortja kishte kryer pagesat, nuk mund të shpjegohet mungesa e lënies gjurmë të këtij interesi real që në kohën kur ai është krijuar. Së treti,

aktet e hartuara përpara kontratës së shitjes, janë të gjitha *jonoteriale*, ndërsa nga ana tjetër, palët në atë kontratë [të shitjes] nuk referojnë asnjë detaj për kontratën e porosisë apo faktin që shlyerja e detyrimit është dokumentuar me mandatpagesat. Këto aspekte zbehin besueshmërinë e pretendimeve për datën kur në *të vërtetë* janë hartuar këto akte.

14.19. Për të gjitha këto arsye, kërkesa e subjektit për ta trajtuar këtë çështje në linjë me arsyetimin e Kolegjit në çështjet e subjekteve të rivlerësimit A. G. apo K. S., si pasuri e krijuar përpara martesë e që nuk duhet ta penalizojë atë, është e pabazuar dhe nuk mund të argumentohet se gjen zbatim në këtë rast. Ky konstatim mban në konsideratë edhe që bashkëshortja e subjektit ka pranuar fillimisht se ka kontribuar edhe ajo *me pagat e saj*, ndërsa prindërit e saj rezultojnë me pamundësi, thuajse në një vlerë të barabartë me apartamentin për investimin në blerjen e tij. Të gjitha këto detaje, sikurse edhe problematikat e tjera të krijimit të pasurisë objekt analize, e bëjnë të pabesueshme panoramën e pretenduar nga subjekti për mënyrën se si është krijuar kjo pasuri e për kontribuuesin/t e mirëfilltë apo se nuk përbën investim të tij e të bashkëshortes. Kontradiktat që rezultojnë nga krahasimi mes pretendimeve nga njëra anë dhe këtyre aspekteve që rezultojnë nga aktet, nga ana tjetër, janë të konsiderueshme.

14.20. Trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se, duke mbajtur në konsideratë garancitë procedurale të subjektit në ankim, këto problematika u bënë pjesë e vlerësimit në kontekstin e besueshmërisë së subjektit në kontrollin e kriterit të pasurisë, ndërsa për efekt të analizës financiare, kjo pasuri nuk u përfshi dhe nuk iu ngarkua subjektit të rivlerësimit. Balanca negative e përftuar në Kolegj në funksion të krijimit të kësaj pasurie në ngarkim të prindërve të bashkëshortes është zbutur, por gjithsesi mbetet. Të ardhurat, sikurse në Komision, për shkak të garancive procedurale, janë përlllogaritur bruto për vitet 2002 – 2005. Edhe shpenzimi është përlllogaritur sipas kontratës dhe jo sipas vlerës së deklaruar për punimet “deri në 3.1 milionë lekë”.

### *III. Depozita në vlerën 43.000 euro, në emër të personit fizik A. S.*

15. Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur me subjektin/bashkëshortja ka deklaruar depozitën e personit fizik me emrin e saj, në shumën 43.000 euro. Komisioni<sup>54</sup> ka vlerësuar përfundimisht se, për vitin 2016, ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare e familjes së subjektit të rivlerësimit, në masën (-) 2.044.199 lekë. Kjo pamjaftueshmëri ka përbërë bazë për deklarimin e pamjaftueshëm, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion, Komisioni mbajti në konsideratë situatën e re që rezultoi nga aktet dhe shpjegimet e subjektit për gjetjet e njoftuara me rezultatet e hetimit. Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të viteve vijuese, Komisionit i rezultoi se, në vitin 2016, ishte zeruar zëri “debitorë të tjerë”, çka tregon se, në vitin 2016, bashkëshortja e kishte kthyer në aktivitet një shumë të tërhequr në vitin 2013. Për pasojë, kthimi i këtyre shumave ndikoi në rillogaritjen e të ardhurave të familjes për vitin 2016, duke ulur totalin e mjeteve të disponueshme dhe duke krijuar një balancë negative prej (-) 2.044.199 lekësh, për këtë vit. Në këtë vlerësim, Komisioni konstatoi se bashkëshortja e subjektit kishte përfituar, së paku, 2.400.000 lekë nga parapagimet për shërbime përmbarimore dhe 2.100.000 lekë nga fitimi i vitit të mëparshëm, çka justifikon shumën prej 4.000.000 lekësh,

<sup>54</sup> Dy anëtarët në shumicë.

të përdorur për hapjen depozitës bankare. Nga analiza financiare e rishikuar, ndryshe nga rezultatet e hetimit, subjekti rezultoi me mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për vitin 2013.

15.1. Subjekti i rivlerësimit ankimon konkluzionin e Komisionit në lidhje me depozitat e viteve 2014 – 2016, që kanë shërbyer si burim krijimi i depozitës objekt kontrolli. Në mënyrë të përmbledhur, kundërshtimet e tij për këtë konkluzion kontestojnë që: (i) Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove për rezultatin financiar negativ të vitit 2016, me të cilin subjekti u njoh vetëm pas publikimit të vendimit përfundimtar, duke cenuar rëndë të drejtën për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar në mënyrë efektive. (ii) Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove për mospërputhjen mes gjendjes së llogarive bankare dhe shumës që i korrespondonte këtij zëri në pasqyrat financiare të personit fizik, duke i mohuar të drejtën për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar. (iii) Komisioni në mënyrë të padrejtë kreu analizën e të ardhurës neto të disponueshme mbi bazën e pasqyrave financiare dhe jo mbi bazën dokumentacionit bankar për vitin 2016. Analiza financiare e vitit 2016 është e gabuar. Komisioni ka shtuar padrejtësisht zërin “banka të tjera”, në shumën 1.607.897 lekë, në kundërshtim me informacionin bankar, nga i cili, gjendja e llogarive bankare të personit fizik A. S., deri më datë 31.12.2016, ishte 530.933 lekë, si rrjedhojë, balanca negative për vitin 2016 është (-) 447.185 lekë, kundrejt (-) 2.044.199 lekë, të përlllogaritur nga Komisioni. Metodologjia e ndjekur nga Komisioni është e pasaktë. Fitimi neto i tërhequr nga personi fizik mund të lexohet vetëm përmes pasqyrave financiare. Subjekti kërkon nga Kolegji njohjen e vlerave reale të fitimit neto, bazuar në pasqyrat financiare zyrtare dhe natyrën specifike të aktivitetit të ushtruar.

*Pretendimet e themelit për rregullsinë dhe metodologjinë e analizës financiare të Komisionit*

16. Në ankim dhe në parashtrimet e depozituara në Kolegji, subjekti pretendon se fakti që gjendja e bankave e konfirmuar për vitin 2016 përputhet me bankën e vetme të deklaruar në pasqyrat financiare të vitit 2015, dëshmon se nuk ka pasur lëvizje të reja apo llogari shtesë, që të justifikojnë ndryshimin drastik në zërin “Banka”, në vitin 2016. Në mungesë të ndonjë dokumenti mbështetës për këtë pretendim, deklarimi në pasqyrat financiare duhet të konsiderohet si “gabim kontabël material” dhe nuk mund të merret si bazë për penalizim të subjektit të rivlerësimit. Subjekti pretendon se gabimi material i evidentuar në pasqyrat financiare të vitit 2016, nuk mund të përkthehet në përgjegjësi të natyrës përjashtuese për subjektin, kur ai nuk ka pasur rol apo dijeni mbi hartimin teknik të këtyre dokumenteve, të cilat janë përgatitur nga persona të autorizuar në emër të aktivitetit të bashkëshortes. Gjithashtu, subjekti pretendon se, nga verifikimi i situatës reale financiare rezulton se pamjaftueshmëria faktike për vitin 2016 nuk është ajo e përlllogaritur nga Komisioni në shumën (-) 2.044.199 lekë, por një balancë negative shumë më e vogël, prej vetëm (-) 447.815 lekë. Mbështetur në aktin e ekspertimit financiar, subjekti shprehet se metodologjia e ndjekur nga Komisioni nuk merr parasysh faktin se fitimi neto i tërhequr nga personi fizik mund të lexohet vetëm përmes pasqyrave financiare. Tërheqja e fitimit në vitin 2016 ka parasysh fitimin neto të realizuar në vitin 2015, pas mbylljes së bilancit vjetor. Në përfundim, subjekti kërkon rishikimin e metodologjisë së përdorur nga Komisioni dhe njohjen e vlerave reale të fitimit neto, bazuar në pasqyrat financiare zyrtare dhe natyrën specifike të aktivitetit të ushtruar.

16.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti rezulton me *mungesë* burimesh të ligjshme të ekonomisë së tij familjare, për të mbuluar *një pjesë të* veprimeve financiare të kryera në funksion

të krijimit të kësaj pasurie, në dhjetor 2016, edhe pasi u korrektova analiza e kryer nga Komisioni. Balanca negative e burimeve të ligjshme, për vitin 2016, konfirmohet edhe nga vetë subjekti në parashtrimet në seancën gjyqësore publike në Kolegj. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, edhe në versionin më të mirë të mundshëm për këtë pasuri, të pranuar prej subjektit. Nga ana tjetër, edhe në vlerësimin e Kolegjit, subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm vlerat financiare respektive dhe arsyet ligjore për të cilat interesat financiarë privatë të personit të lidhur, likuiditetet në llogari/depozitë bankare si individ dhe likuiditetet në llogari/depozitë bankare të personit fizik janë ndërthurur në mënyrë të vazhdueshme, thuajse pandashmërisht, në më shumë se një rast, e lëvizur në të dyja kahet, më së paku në harkun kohor nga viti 2013 e në vijim.

**16.2.** Nga aktet në fashikull, por edhe pohimet e subjektit, rezulton se ai dhe personi i lidhur/bashkëshortja janë sjellë me këto depozita si pasuri personale/e ekonomisë familjare, ndërsa formalisht ato janë emërtuar si pronë e disponim i personit fizik. E tillë rezulton blerja tërësisht me fondet nga kjo depozitë, e një apartamenti tjetër, në vitin 2018, të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, brenda kompleksit “{\*\*\*}”, apo edhe mospasqyrimi i ekzistencës së saj [depozitës] në pasqyrat financiare të personit fizik. Duke mbajtur në konsideratë këtë konstatim, si dhe shpjegimet kontradiktore të subjektit gjatë gjithë procesit, përfshirë edhe pohimet në seancën publike në Kolegj, trupi gjykues vëren se subjekti ka treguar mungesë transparence në shpjegimin e pasurive e të ardhurave në procesin e rivlerësimit, duke pamundësuar identifikimin e saktë të vijës ndarëse mes këtyre dy zërave pasurorë. Vlerësuar nën dritën e detyrimeve të tij në procesin e rivlerësimit, ky konstatim përbën deklaram të pasaktë, në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**16.3.** Vlerësimi i mësipërm u bazua në situatën faktiko-ligjore që rezultoi gjatë verifikimit të pretendimeve të ngritura në ankim, parashtrime dhe gjatë seancës gjyqësore publike, të zhvilluar në Kolegj, shtjelluar në detaj, në vijim të këtij vendimi.

**16.4.** Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur me subjektin/bashkëshortja, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj depozite. Në deklaratën për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitën bankare të bashkëshortes, numrin e kësaj llogarie, datën e krijimit [09.08.2013] dhe vlerën prej 4.000.000 lekësh. Po aty, ai ka deklaruar se depozita është derivat i transferimit të llogarisë së biznesit nga veprimtaria si përmbaruese gjyqësore private dhe se është shtuar për vitin, në vlerën 5.121.158,14 lekë. Në deklaratën periodike për vitin 2016 [dorëzuar në datën 21.03.2017, dy muaj pas deklaratës *vetting*], subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë në BKT, më datë 23.12.2016 dhe vlerë 43.000 euro, në llogarinë e bashkëshortes “si notere”, kaluar nga llogaria personale pranë BKT-së.

**16.5.** Bazuar në dokumentacionin e administruar dhe në deklaramet e mësipërme, rezulton se depozita objekt kontrolli, krijuar në datën 23.12.2016, është derivat i dy burimeve e konkretisht: (i) shumës 37.371 euro, të transferuar nga llogaria personale e bashkëshortes, në BKT dhe (ii) shumës 5.197 euro, të transferuar nga llogaria e personit fizik, po në këtë bankë.

**16.6.** Nga kontrolli i llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit, në BKT, rezulton se shuma 37.371 euro, e transferuar nga llogaria personale e bashkëshortes, është derivat i konvertimit të shumës 5.125.158 lekë, në datën 21.12.2015, të disponuar më herët në llogarinë bankare të depozitës (jo si person fizik), në të njëjtën bankë të saj. Edhe vetë shuma prej 5.125.158 lekësh ishte krijuar nga dy nënburime e konkretisht nga:

- (i) Depozita me afat, prej 4.000.000 lekësh, e hapur në datën 09.08.2013 dhe e krijuar nëpërmjet depozitimit të shumës 300.000 lekë, në datën 02.08.2013, shumës 400.000 lekë, në datën 05.08.2013 dhe shumës 3.300.000 lekë, në datën 09.08.2013. Në DIPP-në 2015, subjekti ka deklaruar se këto të ardhura janë krijuar nga veprimtaria e biznesit të bashkëshortes si përmbaruese gjyqësore private.
- (ii) depozita me afat, prej 1.345.500 lekësh, e hapur në datën 26.06.2015, e krijuar nëpërmjet shumës 500.000 lekë,<sup>55</sup> të transferuar në datën 23.06.2015, nga llogaria e personit fizik, në BKT [me burim krijimi, aktivitetin si notere]; dhe (ii) shuma prej 865.500 lekësh, e depozituar *cash* nga A. S., në datën 26.06.2015, e tërhequr nga bashkëshortja e subjektit, në po të njëjtën datë, nga llogaria personale e kursimit në “Tirana Bank”, e krijuar nga depozitimet e vitit 2003 (shuma 173.000 lekë) dhe vitit 2011 (shuma 496.500 lekë).
- (iii) Dy depozitat e mësipërme, me vlerë 4.000.000 lekë dhe 1.345.500 lekë, u bashkuan në datën 27.08.2015, në një depozitë të vetme, me vlerë 5.114.321 lekë.<sup>56</sup>

**16.7.** Me rezultatet e hetimit, subjektit i kaloi barra e provës për mungesën e burimeve të ligjshme financiare prej (-) 2.015.030 lekësh, për depozitimet që ka kryer bashkëshortja, në funksion të krijimit të depozitës -- përkatësisht (-) 1.895.236 lekë, në vitin 2013 dhe (-) 119.794 lekë, në vitin 2011. Subjekti ka argumentuar se depozita e kursimit është krijuar me të ardhurat nga aktiviteti, të cilat u kaluan në ekonominë familjare. Këto të ardhura kanë qenë më të larta, pasi shumat e tërhequra nga llogaritë bankare të personit fizik, gjatë vitit 2013, kishin si burim jo vetëm fitimin e vitit paraardhës 2012, por edhe shumat e parapagimeve për kryerjen e veprimeve përmbarimore gjatë vitit 2013. Subjekti, po ashtu është shprehur se, në vitin 2013, përpos tërheqjes së fitimit të vitit 2012, janë tërhequr edhe fonde, të cilat në “aktiv” janë regjistruar gabimisht në zërin “kërkesa të arkëtueshme”, që në fakt përbëjnë fitime të vitit 2013, sikurse rezulton edhe nga analizat dhe pasqyrat financiare të viteve në vijim. Pasqyrimi i gabuar i parapagimeve në pasqyrën financiare të vitit 2013, është saktësuar kur janë riklasifikuar në zërin “debitorë të tjerë”, në pasqyrat e vitit 2014. Subjekti ka pretenduar se, në një lexim harmonik të tërheqjeve nga llogaritë bankare, me pasqyrat financiare të vitit 2013, vlerat e shënuara në zërin “kërkesa të arkëtueshme”, në fakt përbëjnë të drejtat e personit fizik nga tërheqjet e kryera prej bashkëshortes, si e vetëpunësuar, si edhe të drejtat nga klientët. Nën këtë linjë arsyetimi, bashkëshortja e tij do të rezultonte me *mjaftueshmëri* të burimeve të ligjshme financiare për depozitimimin e shumës 4.000.000 lekë, në vitin 2013. Balanca e vitit 2011, nuk mund të rezultonte me mungesë burimesh, për sa kohë nga

<sup>55</sup> Nga kjo vlerë, 20.000 lekë, janë transferuar në një llogari tjetër, nga A. S., në të njëjtën datë.

<sup>56</sup> Diferenca e tërhequr *cash* nga bashkëshortja e subjektit, në të njëjtën datë.

viti paraardhës 2010, ai dispononte gjendje *cash*, të cilat kishte mundësi t'i përdorte gjatë vitit 2011.

**16.8.** Komisioni ka pranuar pretendimet e subjektit, duke konkluduar përfundimisht se bashkëshortja e tij ka pasur burime të mjaftueshme financiare nga aktiviteti për çeljen e depozitës prej 4.000.000 lekësh, në vitin 2013. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren mungesë arsytimi në vendim. Komisioni nuk rezulton të jetë shprehur me një konkluzion përfundimtar për depozitat e bashkëshortes gjatë vitit 2015, që kishin filluesën nga ato të vitit 2011, për të cilat gjatë hetimit administrativ, subjekti kishte rezultuar me pamjaftueshmëri burimesh. Për rrjedhojë, subjekti nuk ngre pretendime për analizën financiare të vitit 2011 dhe 2013.

**16.9.** Komisioni ka rishikuar analizën financiare. Konkretisht, në analizën e vitit 2013, përveç fitimit të vitit 2012, Komisioni ka përfshirë si të “ardhur/të hyrë”, edhe shumën prej 2.310.739 lekësh, me përshkrimin “parapagim nga aktiviteti/kthim aktiviteti”, ndërsa në analizën e vitit 2016, e njëjta shumë është reflektuar si e paguar (e kthyer) në të njëjtin nënzë, të emërtuar “parapagim nga aktiviteti/kthim aktiviteti”. E thënë ndryshe, në vitin 2016 është zeruar zëri “debitorë të tjerë”, në të cilin, sipas pretendimeve të subjektit, ishin të përfshira dhe të drejtat financiare të pritshme që kishte personi fizik/aktiviteti nga pronari/bashkëshortja e subjektit. Ky fakt nënkupton në terma praktikë, që shuma 2.310.739 lekë, e tërhequr nga aktiviteti në vitin 2013 dhe e përdorur për krijimin e depozitës 4.000.000 lekë, prej bashkëshortes, i është kthyer mbrapsht personit fizik, në vitin 2016, nga ekonomia familjare e subjektit.

**16.10.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren si vijon:

a. Depozita 4.000.000 lekë, e krijuar në vitin 2013, nga bashkëshortja e subjektit, me burim tërheqjet nga llogaritë e personit, konsiston në vlerën 2.104.764 lekë – nga fitimi i vitit 2012 – dhe diferenca, parapagimet në llogarinë e personit fizik nga veprimet përmbarimore. Nga konfermat bankare rezulton se nga ky zë përfitimesh, gjatë vitit 2013, bashkëshortja e subjektit ka arkëtuar së paku një shumë rreth 2.400.000 lekë, e cila së bashku me fitimin e vitit të mëparshëm, rreth 2.100.000 lekë, plotëson shumën prej 4.000.000 lekësh, për çeljen e depozitës bankare në analizë.

b. Në datën 23.12.2016, bashkëshortja e subjektit transferoi 37.371,25 euro/5.048.445 lekë, nga llogaria e saj *personale* në euro, në llogarinë e saj si *person fizik* në BKT, duke krijuar një depozitë të re, në vlerën 43.000 euro. Është kjo depozitë në emër të personit fizik/aktivitetit, nga e cila, në vitin 2018, u përdorën fondet për të investuar me apartamentin në kompleksin turistik “{\*\*\*}”, Vlorë, në emër të bashkëshortes së subjektit. Transfertat për blerjen e apartamentit janë kryer nga llogaria e personit fizik, respektivisht në datat 21.05.2018 dhe 10.07.2018.

c. Për përlllogaritjen e të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes së subjektit, për vitet 2013 – 2016, Komisioni i është referuar bilanceve të dorëzuara nga personi fizik, organeve tatimore. Shuma e të ardhurave nga aktiviteti, e përlllogaritur nga Komisioni, nuk përfaqëson fitimin neto të vitit paraardhës, por të ardhurat neto të disponueshme për personin fizik. Në këto të ardhura, Komisioni ka konsideruar fitimin neto të vitit dhe zëra të tjerë, përfshirë ndryshimin në llogaritë e

arkëtueshme, në gjendjet e llogarive bankare të personit fizik, si dhe ndryshimet në makineritë dhe pajisjet/apo inventarin, nga viti 2013 deri në vitin 2016.

d. Nga shqyrtimi në Kolegj i pasqyrave financiare të personit fizik (bashkëshortes), për vitin 2016, ka rezultuar se deklarimi pranë organeve tatimore, i zërit “Banka”, në fund të vitit 2016, është në vlerën 2.138.830 lekë, ndërsa gjendja reale e llogarive bankare të personit fizik, në fund të vitit 2016, është në vlerën 530.933 lekë. Me fjalë të tjera, rezulton një diferencë prej 1.607.897 lekësh, mes zërit të referuar si “Banka”, në pasqyrën financiare të vitit 2016, me gjendjen reale në bankë, që ka përfshirë Komisioni në përlllogaritjen e të ardhurës neto të disponueshme, për vitin 2016. Gjithashtu, rezulton se depozita në vlerën 43.000 euro, e çelur në vitin 2016, në emër të personit fizik, nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të këtij viti.

16.11. Referuar konstatimeve të mësipërme, trupi gjykues çmoi me rëndësi të pyeste subjektin gjatë seancës gjyqësore publike në Kolegj. Subjekti iu shmang dhënies së përgjigjeve koherente për dy pyetje të trupit gjykues. Konkretisht, pyetur për arsyen e mosreflektimit të depozitës së vitit 2016, në pasqyrat financiare të personit fizik, subjekti nuk dha shpjegim konkret, por ia atribuoi gjendjen një gabimi material të kryer nga ekonomistja e personit fizik. Nga ana tjetër, ai nuk dha asnjë shpjegim se përse fondet e depozitës, me titullar *personin fizik*, u përdorën për blerjen e një apartamenti banimi në pronësi të subjektit dhe të bashkëshortes. Për pasojë, këto dy aspekte, me rëndësi për qartësimin e situatës faktike, mbetën të pashpjeguara.

16.12. Trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se pasqyrimi nga Komisioni në zërin “Banka”, i vlerës 1.607.897 lekë më tepër se vlera reale [prej 530.933 lekësh], në pasqyrat financiare, është kryer për të barazuar totalin e pasivit me totalin e aktivit, duke e mbivendosur artificialisht si gjendje ekzistuese. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mbajti në konsideratë që: (i) gjendja *faktike* e llogarive bankare të personit fizik, në fund të vitit 2016, është në shumën 530.933 lekë; (ii) shuma prej 1.607.897 lekësh nuk i përket asnjë llogarie bankare të disponueshme të personit fizik, në fund të vitit 2016; (iii) nuk ekziston asnjë provë që kjo shumë të jetë përdorur nga subjekti dhe bashkëshortja e tij për krijimin e ndonjë pasurie; (iv) pasqyrat financiare të vitit 2016 paraqesin edhe gabime të tjera, pasi nuk përfshijnë vlerën e depozitës prej 43.000 euro, në emër të personit fizik. Kjo nënkupton që diferenca midis gjendjes reale në bankë me atë të deklaruar në pasqyrat e dorëzuara në organin tatimor, përbën përlllogaritje të pasaktë. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se, në analizën e të ardhurës neto të disponueshme për vitin 2016, zëri “Banka të tjera” nuk duhet të pasqyrohej, sepse nuk ekziston realisht. Ky zë u korrigjua në analizën e kryer në Kolegj mbi bazën e dokumentacionit bankar për këtë vit, duke passjellë ndryshim të vlerës së të ardhurës neto të disponueshme për vitin 2016. Si rrjedhojë, korrektimi passolli edhe ndryshim të rezultatit financiar për vitin 2016, i cili përmirësohet, por gjithsesi mbetet me një balancë negative prej (-) 447.815 lekësh, kundrejt balancës negative prej (-) 2.044.199 lekësh, të rezultuar në Komision.

16.13. Në përmbledhje të verifikimeve të kryera për këtë depozitë bankare, trupi gjykues nënvizon së pari se, ndonëse në deklaratën *vetting*, kjo depozitë është deklaruar në emër të personit fizik, subjekti dhe bashkëshortja janë sjellë si pronarë të saj. *Së dyti*, veprimet e kryera me këtë depozitë

dhe dinamika e lëvizjes së fondeve në të dyja kahet, e për më tepër, *pa* lënë gjurmë në pasqyrat financiare të kohës të personit fizik, sidomos transferta e vitit 2016, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se kjo depozitë, në fakt, i përket ekonomisë *familjare* dhe jo aktivitetit të bashkëshortes. Subjekti dhe bashkëshortja janë sjellë me këto depozita, si të jenë pasuri personale/e ekonomisë familjare, ndërsa formalisht ato janë emërtuar si pronë e disponim i personit fizik. Këtë dyshim e përforcon edhe fakti që në vitin 2018, kjo depozitë e personit fizik u përdor për blerjen e një apartamenti banimi në kompleksin “{\*\*\*}” në bashkëpronësi të dy bashkëshortëve. Thënë më thjesht, nëse fondet e depozitës së personit fizik do të ishin përdorur për blerjen e një zyre/ambienti apo për blerjen e një investimi në funksion të ushtrimit të aktivitetit, pretendimi që kjo depozitë është pasuri e personit fizik, mund të bënte kuptim.

16.14. Për sa më sipër, edhe në vlerësimin e Kolegjit, subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm vlerat financiare respektive, arsyet ligjore për ndërthurjen e interesave financiarë privatë të personit të lidhur pandashmërisht, në më shumë se një rast, e lëvizur në të dyja kahet, më së paku në harkun kohor nga viti 2013 e në vijim, apo mospasqyrimin e ekzistencës së depozitës në pasqyrat financiare të personit fizik, dhe mënyrën nëpërmjet të cilës këto fonde janë dedikuar pasurisë së krijuar në një zonë ekskluzive bregdetare. Duke mbajtur në konsideratë këtë konstatim dhe shmangien e përgjigjeve nga subjekti, edhe në në seancën publike në Kolegj, trupi gjykues vëren se subjekti ka treguar mungesë transparence në shpjegimin e pasurive e të ardhurave në procesin e rivlerësimit, përfshirë edhe nëpërmjet mjegullimit të të vijës ndarëse mes aspekteve të ndryshme financiare. Vlerësuar nën dritën e detyrimeve të tij në procesin e rivlerësimit, ky konstatim përbën deklaram të pasaktë, në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e tjera të subjektit për këtë pasuri u vlerësuan pa peshë përcaktuese në zgjidhjen e çështjes, për sa kohë u arrit në konkluzionin e mësipërm.

#### *Pretendimet procedurale për barrën e provës*

17. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka depozituar një akt-raport të analizës financiare, të përgatitur nga audituesi ligjor, të cilin kërkoi të administrohet në Kolegj, në cilësinë e provës së re me ankimin. Ky akt u pranua në Kolegj, sikurse arsyetuar më lart, si pjesë e arsyetimit për formën e shqyrtimit të çështjes. Nga ana tjetër, pretendimet që lidhen me aspekte procedurale të këtij shkak ankimi janë të pabazuara. Nga aktet në fashikull rezulton se subjektit i ka kaluar barra e provës për këtë aspekt. Sikurse arsyetuar më sipër gjerësisht, Komisioni ka kryer një analizë për depozitën e krijuar nga bashkëshortja [e cila u korrekta nga Kolegji gjatë kontrollit të vendimit].

17.1. Konkretisht, pasi Komisioni konstatoi se gjendja e llogarive bankare të aktivitetit në fund të vitit 2016, ishte në shumën 2.138.830 lekë dhe se bashkëshortja e subjektit nuk ka deklaruar dhe një gjendje bankare në shumën rreth 1.607.897 lekë, nëpërmjet pyetësorëve dhe rezultateve të hetimit, Komisioni i ka kërkuar<sup>57</sup> subjektit të rivlerësimit, të *specifikojë konkretisht* se cilat llogari bankare rrjedhëse/depozitë apo të çfarëdo lloj forme, janë përfshirë në zërin përkatës të gjendjeve bankare në bilancet e dorëzuara nga personi fizik, pranë organeve tatimore për vitin 2016, që kanë

<sup>57</sup> Pyetësori nr. 5, pyetja 2; pyetësori nr. 6, pyetja 2, rezultatet e hetimit pika 6.4, nënpika iv.

përbërë gjendjen e deklaruar. Në përgjigje të pyetësorëve, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar për vitin 2016, se shuma 2.138.830 lekë është gjendja e llogarisë “Banka” në bilancin e personit fizik në emër të bashkëshortes së tij.<sup>58</sup> Ndryshe nga sa i ishte kërkuar në pyetësorë, subjekti nuk ka specifikuar llogaritë konkrete bankare apo të çfarëdo lloj forme, të përfshira në këtë përlllogaritje të kryer.

17.2. Në raportin e rezultateve të hetimit, Komisioni fillimisht ka renditur llogaritë e deklaruara dhe ato të padeklaruara, të cilat i ka vlerësuar jopenalizuese, duke i konsideruar si një harresë të subjektit. Në vijim, Komisioni, po ashtu, ka referuar sa arsyetuar më sipër për mosdeklarimin e vlerës rreth 1.607.897 lekë, nga personi fizik, dhe i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, përfshirë edhe për mosdeklarimin e llogarive të personit fizik ndër vite. Bashkëlidhur rezultateve të hetimit, subjektit i është vënë në dispozicion edhe analiza financiare në formatin *Excel*. Në faqen “Personi fizik”, të këtij dokumenti në *Excel*, shuma 1.607.897 lekë, e pretenduar nga subjekti se nuk i është njoftuar, rezulton se është e përfshirë rubrikën “Bankat A. S.”, zëri “Tjetër llogari bankare A. S. PF”.

17.3. Në prapësimet kundër rezultateve të hetimit, subjekti *nuk* ka dhënë shpjegime për sa më sipër. Ndërsa në seancën dëgjimore në Komision, në lidhje me llogaritë e bashkëshortes si person fizik/notere, subjekti *ka pohuar* se është njoftuar nga Komisioni se nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting*, llogaritë bankare të personit fizik. Edhe në atë moment procedural, subjekti nuk ka dhënë shpjegime mbi llogaritë konkrete bankare apo të çfarëdo lloj forme, të përfshira në gjendjen e llogarive “Banka”, të aktivitetit në fund të vitit 2016, sipas pasqyrave financiare.

17.4. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit, për mosnjohje të situatës e pamundësim në praktikë të së drejtës për t’u mbrojtur, është i pabazuar. Qartazi, subjekti në ankim konteston jo njohjen me analizën, por mundësinë e tij për të kuptuar përmbajtjen. Kjo mënyrë parashtrimi është një pretendim i pasinqertë për sa kohë rezulton e provuar që:

a. Konstatimi (...) *nisur nga gjendja e llogarive bankare të aktivitetit në fund të vitit 2016, në shumën 2.138.830 lekë, duket se, përveç llogarive të sipërpërmendura, nuk është deklaruar dhe një gjendje bankare në shumën rreth 1.607.897 lekë (...), i është bërë me dije me rezultatet e hetimit në formë narrative, e tekstualisht si riprodhuar më sipër, jo vetëm në raportin analitik/tabelor, në formatin Excel, por edhe në raportin e shkruar.*

b. Nuk rezulton që subjekti, pas njohjes me rezultatet e hetimit dhe analizës financiare bashkëlidhur tyre, të ketë pretenduar se ka pasur vështirësi në të kuptuarin e analizës financiare. Nëse do të ishte ngritur ky pretendim, Komisioni, në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 44/2015<sup>59</sup>, do

---

<sup>58</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 5 subjekti shprehet literalisht: “[...] Viti 2016, gjendja e deklaruar 2.138.830 lekë, kjo është gjendja e llog. Banka në bilancin e subjektit tatimor A. S. dhe jo e individit [...]”. Në përgjigje të pyetësorit nr. 6 shprehet: “[...] Viti 2016, gjendja e deklaruar 2.138.830 lekë, është gjendja e llog. Banka në aktivin e bilancit të subjektit tatimor A. S. (këtë vit notere e licencuar), pra kjo është gjendja e llogarive bankare të subjektit tatimor dhe jo e individit [...]”.

<sup>59</sup> Kodi i Procedurave Administrative.

të kishte pasur detyrimin për të garantuar që padija e subjektit të mos përkeqësonte mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave që gëzon subjekti sipas ligjit.<sup>60</sup>

c. Edhe në kuptim të nenit 23 të Kodit të Procedurës Civile,<sup>61</sup> subjekti ka pasur mundësi të asistohet nga një ekspert kontabël, sikundër realisht ka ndodhur. Në pikën nr. 84 të prapësimeve, subjekti ka shpjeguar *se është asistuar nga një auditues ligjor*. Po kështu, edhe në seancën dëgjimore në Komision, subjekti ka deklaruar se është asistuar nga një auditues ligjor dhe ka depozituar, në cilësinë e provës, një akt ekspertimi të përgatitur nga ky i fundit. Këto fakte rrëzojnë pretendimin se nuk ka pasur mundësi të kuptonte analizën financiare të njoftuar me rezultatet e hetimit.

17.5. Në përmbyllje, për sa i përket pretendimeve për moskalim të barrës së provës në lidhje me balancën financiare përkeqësuese mes rezultateve të hetimit dhe asaj në vendim, trupi gjykues vëren se, në pamje të parë, rezultojnë një diferencë prej 243.288 lekësh me e thellë në vendim, e konkretisht (-) 3.235.593 lekë [në vendim] kundrejt (-) 2.992.305 lekë [në rezultatet e hetimit]. Ky ndryshim, që është rezultat i përmirësimit të analizës në vitin 2013 dhe i përkeqësimit në vitin 2016, rezultojnë të jetë për zëra, për të cilët subjekti *i ka kaluar* barra e provës dhe ka dhënë shpjegime, që nënkuptojnë që mundësia për t'u mbrojtur është shteruar parimisht. Të kuptuarit ose jo i këtij rezultati nga ana e subjektit, nuk përbën cenim të së drejtës për t'u mbrojtur, për më tepër që subjekti ka pranuar se është ndihmuar edhe nga një ekspert i fushës, e po ashtu, nuk ka pretenduar në Komision, paqartësi apo vështirësi në të kuptuarit e raportit të rezultateve të hetimit dhe të analizës financiare. Nga ana tjetër, në kushtet që ankimi iu nënshtrua kontrollit të Kolegjit, subjekti u dëgjua në seancë publike në Kolegj dhe dha shpjegime *edhe* për këtë aspekt financiar, dhe analiza financiare e korrigjuar në Kolegj rezultoi në vlerën prej (-) 1.639.209 lekësh, ose nën vlerën e konstatuar në rezultatet e hetimit, ky aspekt i ankimit konsiderohet i shteruar si pasojë e këtij vendimi të Kolegjit.

18. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, për periudhën e rivlerësimit 2005 – 2016, sikurse referuar edhe më sipër, edhe pas korrektiveve të kryera në Kolegj për shkaqet e ankimit që u vlerësuan të bazuara, rezultuan balanca negative për të kryer shpenzimet dhe krijuar kursimet e deklaruar më së paku për tre vite, në total në vlerën prej (-) 1.639.209 lekësh, e cila përfshin edhe balancën negative të pranuar nga subjekti, për vitin 2016. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që kjo vlerë është ajo më *e favorshme*. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se për subjektin e rivlerësimit nuk ka vend të zbatohet parimi i proporcionalitetit, nëse mbahen në konsideratë problematikat e pasurisë arsyetuar gjerësisht në këtë vendim, sikurse edhe problematikat e tjera të

---

<sup>60</sup> Neni 10 i ligjit nr. 44/2015, parashikon: *Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre. 2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik. 3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave që pala gëzon sipas ligjit.*

<sup>61</sup> Neni 23 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon: *“Palët janë të lira të ndërtojnë mbrojtjen e interesave të tyre në gjykim, nëpërmjet përfaqësimit ose të çdo ndihme tjetër juridike, në përputhje me dispozitat në fuqi”.*

vlerësimin të kriterit të pasurisë, që janë kaluar në heshtje apo ato për të cilat Komisioni ka dhënë zgjidhje kontradiktore ose të munguar tërësisht, sikurse edhe problematikën e apartamentit në emër të personit të lidhur. Tërësia e të gjitha problematikave që janë konfirmuar edhe në Kolegj, së bashku me ato për të cilat Komisioni ka munguar të kryejë hetim apo vlerësim adekuat, janë të tilla që subjekti nuk arrin nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, sipas përcaktimit të shprehur të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

19. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit *ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme* për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe është në kushtet e deklarimit të pasaktë, sipas përcaktimeve të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit *nuk arrin nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë dhe vendimi nr. 547 datë 06.07.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i bazuar në fakte e në ligj dhe duhet të lihet në fuqi.*

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 547, datë 06.07.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Çlirim Sino.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 23.06.2025, në Tiranë.

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*